

1 E enjte, 14 shtator 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 [I akuzuari Krasniqi paraqitet përmes
5 videolidhjes]

6 --- Seanca fillon në orën 09.00

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Znj.

8 Sekretare, paraqisni lëndën ju lutem.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
10 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
11 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
12 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
14 Mirëmëngjes, të gjithë. Sot do të vazhdojmë me kundërpjetjen e
15 Dëshmitarit të Prokurorisë 3724.

16 Përpara sesa të fillojmë me marrjen në pyetje të
17 dëshmitarit, dua t'ju kërkoj palëve të thonë në qoftë se ka
18 ndonjë ndryshim lidhur me kohën e parashikuar për pyetjen e
19 dëshmitarit.

20 Z. Roberts?

21 Z. ROBERTS: [Përkthim] Jo, i nderuar Gjykatës. Mendoj që
22 do më duhet rreth një orë sot paradite.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis?

24 Z. ELLIS: [Përkthim] Do të na duhet pak a shumë një orë
25 për këtë dëshmitar.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Emmerson?

2 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk kemi ndryshim.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic?

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Më duhet 30 deri në 45 minuta.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson,
6 nuk e dëgjova mirë çfarë thatë?

7 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk ka ndryshim në vlerësimin e
8 kohës që na duhet për marrjen në pyetje të këtij dëshmitari.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ishte mirë
10 që të përfundonim me këtë dëshmitar sot, në mënyrë të tillë që
11 të mos duhej që të priste një javë tjetër dëshmitari dhe të
12 vinte përsëri përpara Trupit Gjykues.

13 Pas javës që vjen, kemi tre javë kohë këtu përpara
14 Gjykatës, kështu që do t'i kërkoja ZPS-së që deri në fund të
15 ditës nesër, të na jepni një listë të dëshmitarëve që
16 planifikoni që të thërrisni gjatë kësaj periudhe tre javore në
17 vijim.

18 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Në rregull.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë atëherë.
20 Nuk kemi gjëra të tjera për të sqaruar kështu që do t'i
21 kërkoja Sekretares të sjellë dëshmitarin në sallë.

22 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Në qoftë se më lejoni, dëshiroj që
23 të flas për diçka. E kam fjalën për disa sqarime lidhur me
24 diskutimin e bërë dje ku z. Emmerson bëri një kërkesë për
25 riklasifikimin e diskutimit ligjor, të argumentimit ligjor në

1 përputhje me rregullën 143.

2 Dua që t'i tregoj Trupit Gjykues që jemi siguruar që kemi
3 identifikuar citimet në transkript të cilat duhen redaktuar
4 pasi të bëhet klasifikimi publik i debatit juridik i debatit
5 juridik që patëm dje në sallën e gjyqit.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

7 [Dëshmitari vijon dëshminë]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,
9 Dëshmitar.

10 DËSHMITARI: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jemi gati për
12 të vazhduar me kundërpjetjet tuaja nga z. Roberts. Z. Roberts
13 do vazhdojë aty ku e la dje.

14 Jeni ende në detyrimin të thoni të vërtetën siç ju u
15 vetdeklaruat në betimin solemn që do të thoni të vërtetën dje.

16 Ju kujtoj që ju lutem përgjigjuni pyetjeve qartë me fjali
17 të shkurtra. Nëse nuk e kuptoni një pyetje, lirisht mund t'i
18 kërkoni Avokatit që ta përsërisë pyetjen ose ta shprehë atë
19 ndryshe. Po ashtu, ju lutem thoni se cila është baza e
20 njohurive, fakteve dhe rrethanave për të cilat do të pyeteni.

21 Flisni pranë mikrofonit, bëni një pauzë prej pesë
22 sekondash përpara sesa t'i jepni përgjigje pyetjes së
23 Avokatit. Dje në fakt e respektuat këtë pikë.

24 Në qoftë se doni të bëni ndonjë pushim, na e thoni këtë
25 gjë dhe ne do bëjmë organizimet e nevojshme.

1 Z. Roberts, mund të vazhdoni.

2 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

3 DËSHMITARI: W03724 [Vijon]

4 Pyetje të palës tjetër nga z. Roberts:

5 [Dëshmitari përgjigjet përmes përkthimit]

6 Z. ROBERTS: [Përkthim]

7 PY. Mirëmengjes, Dëshmitar. Shpresoj që të keni pushuar
8 ndopak. Ne po diskutonim dje për nivelin e organizimit të UÇK-
9 së. Në deklaratën që i keni dhënë ZPS-së, në paragrafin 20 dhe
10 do të kërkoja që të paraqitet kjo në ekran dhe e kam fjalën
11 këtu për transkript që thamë dje:

12 "‘I Përgjithshëm’ ishte vetëm Shtabi i Përgjithshëm,
13 ishte në një nivel ushtarak të cilin unë e kisha dëgjuar në
14 lidhje me UÇK-në dhe vetëm sa i takon Drinit, e vërteta ishte
15 që ata donin që të shikoheshin si ushtri e armatosur që
16 funksiononte haptazi me uniformë brenda territorit që
17 kontrollonte".

18 A ju kujtohet ta keni thënë këtë dje?

19 PË. Po.

20 PY. Po pse thoni që e kishin me dëshirë që të shikoheshin më
21 të organizuar, a mund të na e shpjegoni pak më tepër këtë gjë?

22 PË. Ndoshta për dy arsye. Njëra prej të cilave ishte që UÇK-
23 ja të prezantohej në mënyrën më të mirë të mundshme në raport
24 me organizatat ndërkombëtare, përfshirë këtu dhe MVK-në, po
25 gjithashtu edhe organizata të tjera të vendosura në

1 Uashington, në Londër, në Berlin e kështu me rashë. Kështu që
2 sa më i mirë të ishte organizimi që ata përfaqësonin aq më
3 efektive do të ishin marrëdhëniet e tyre.

4 PY. T'ju ndërpres pak këtu për një çast, a ishte qëllimi që
5 t'i inkurajoheshin këto shtete që të ndihmonin ose që të
6 rreshtoheshin në anën e UÇK-së? A ishte ky një lloj ushtrimi i
7 marrëdhënieve publike në qoftë se mund të përdorja këtë lloj
8 terminologjie?

9 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kundërshtoj Për themelin. Sepse po
10 i bëhet pyetje për qëllimin e UÇK-së, çfarë qëllimi kishte
11 UÇK-ja që dëshironte që të dukej më e organizuar dhe
12 dëshmitari nuk e ka këtë njohuri.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.
14 Ndoshta duhet ta përsërisni ose ta bëni dhe njëherë tjetër, z.
15 Roberts.

16 Z. ROBERTS: [Përkthim] Po, patjetër.

17 PY. Edhe njëherë, kush ishte -- ju thatë që qëllimi pas
18 prezantimit të UÇK-së ishte në mënyrë të tillë që të dukej më
19 mirë përpara organizatave ndërkombëtare, si për shembull, MVK-
20 ja apo edhe organizata të tjera në vende të tjera për të
21 inkurajuar ata për të ndërhyrë për të ndihmuar UÇK-në?

22 PË. Mendoj që marrëdhëniet publike do ishin pjesë e madhe e
23 kësaj qasjeje, po gjithashtu sa i takon marrëdhënieve
24 ndërkombëtare. Në mënyrë të kuptueshme ata dëshironin që të
25 shikoheshin si një organizatë me të cilën ti mund të merreshe

1 si palë tjetër dhe që mund të negocionit dhe si rezultat që të
2 kishin një zë më të fortë.

3 PY. Domethënë, donin që të demonstronin legjitimitet në sytë
4 e atyre institucioneve ndërkombëtare, është e drejtë të thuhet
5 kjo gjë?

6 PË. Po.

7 PY. Si rezultat kishte një lloj stimul, një stimul të qartë
8 që kishte ekzagjerim të nivelit të organizimit të UÇK-së,
9 nivelit që ata pretendonin që ishin të organizuar nuk ishte
10 niveli real i organizimit në terren, apo jo?

11 PË. Po.

12 PY. A ishin të gatshëm ata t'ju demonstronin se çfarë
13 sistemesh komunikimi kishin ata?

14 PË. A mund të shtoj diçka.

15 PY. Po, patjetër.

16 PË. Sepse doja të shtoja dhe aspektin e dytë ma ndërpretë
17 këtu fjalën.

18 PY. Sigurisht, mund të vazhdoni.

19 PË. Mund të them që nga marrëdhëniet e mia të zgjeruara me
20 shqiptarët dhe veteranë të UÇK-së pas luftës ishte pjesërisht
21 për shkak të karakterit kombëtar dhe psikologjisë kombëtare të
22 tyre që ata dëshironin që forca e tyre të shihej si e nderuar
23 dhe si përfaqësuese e fitores kombëtare në qoftë se mund ta
24 them këtu. Pra, dua të them që kishin një karakter të fortë
25 kombëtar dhe një ndjesi të madhe të lartë patriotike dhe kjo

1 ishte shumë e dukshme.

2 PY. Faleminderit. Dua që të kalojmë tek komunikimi. Pyetja që
3 bëra përpara sesa të jepnit këtë përgjigje ishte si më poshtë:

4 "A ishin të lutem gatshëm ata që të demonstronin se çfarë
5 sistemesh komunikimi kishin apo përdornin?"

6 PË. Jo, nuk mendoj kështu. Komentet që kam dhënë në
7 deklaratën time lidhur me sistemin e komunikimeve kanë të
8 bëjnë me konstatimet e mia personale. Mund edhe të ketë
9 ndodhur, por mua personalisht, nuk më kujtohet një rast kur
10 një anëtar i UÇK-së mezi priste që të më tregonte se çfarë
11 aftësish kishin ata për të kaluar porosi nga njëri te tjetri.
12 Sigurisht, unë i kam parë ata duke kaluar mesazhe apo porosi
13 por nuk është se ka qenë qëllimi kryesor, le të themi,
14 demonstrimi i mjeteve të komunikimit të tyre për mua.

15 PY. Në fakt, një prej shembujve për të përdorur këtë
16 marrëdhënie për aftësinë për të kaluar porosi ka ndodhur në
17 luftimet në Randubravë në fund të shkurtit 1999. Dhe, për
18 shembull, domethënë, ju duhet që të jepni një mesazh në një
19 porosi për dy burra të cilët shtinin që ishin në një njësit që
20 qëllonin në ajër dhe qëllonin me armë pa bërë fare pa bërë
21 pushim.

22 Domethënë, a donit ju që t'i jepnit një porosi ose një
23 mesazh të caktuar në këtë rast?

24 PË. Po. Nuk ishte një rast ku dikush të thoshte, "Ky është
25 mesazhi specifik, dëshiroj që të jap këtë mesazh për ushtarin

1 X". Dhe, për shembull, në këtë rastin që u përmend komandanti
2 Drini nëpërmjet radios së MVK-së kishte udhëzuar armëpushimin
3 në këtë rast, por në këtë rast bëhet fjalë që unë kam qenë
4 pjesërisht si pjesë e kësaj bisede, megjithatë ishte diçka që
5 nuk do ishte bërë dot në qoftë se nuk do isha unë një person i
6 besuar.

7 PY. Po. Po, si shembull, kjo demonstroi që nuk kishte mundësi
8 që të komunikohesh me ato njësitë në terren në qoftë se nuk do
9 kishte një ndërmjetësues?

10 PË. Në këtë rast konkret ky ushtar apo këta ushtarë nuk është
11 se kishin radiolidhëse në zotërim të tyre.

12 PY. Sa i takon pikave të kontrollit ose punkteve të
13 kontrollit, këto i keni diskutuar në deklaratën tuaj por ju
14 keni thënë që keni parë vetëm dy pika kontrolli gjatë kohës që
15 keni qenë aty në zonën tuaj në CC1, apo jo? Për procesverbal
16 jepet në paragrafin 29 të deklaratës tuaj. Nëse dëshironi mund
17 ta lexojmë për procesverbal për të parë në qoftë se ky
18 informacion është i saktë:

19 "Por dhe anëtarë të tjerë të tjerë formal të CC1 mund të
20 japin shembuj të tjerë, megjithatë me sa më kujtohet, kam parë
21 personalisht vetëm dy shembuj të pikave të kontrollit fizike
22 të UÇK-së".

23 Pra, është e saktë kjo apo që keni parë vetëm dy pika
24 kontrolli të UÇK-së? Në kuptimin që e kishte kuptuar ti që ato
25 kontrolloheshin nga UÇK-ja?

1 PË. Unë vetëm jam ndaluar në ato dy vende. Kam qenë në dijëni
2 edhe të vendeve të tjera. Vende të tjera i kam parë nga larg.
3 Për shembull, i kam parë nga rruga, në shtegun, në rrugën që
4 të çon në Malishevë, ka pasur një rrugë anësore që ka qenë e
5 rëndësishme për UÇK-në, që ishte e rëndësishme për UÇK-në që
6 quhej Dragobil dhe ka qenë dhe aty një pikë kontrolli,
7 megjithatë unë personalisht vetë nuk mbaj mend që e kam kaluar
8 atë pikë kontrolli. Jam i sigurt që ka pasë dhe pika të tjera
9 po që unë nuk kam pasë të bëjë me to, nuk i kam parë.

10 PY. Por gjatë periudhës që keni qenë aty katër-pesë muajve që
11 keni qenë pjesë e CC1, në periudhën midis nëntorit 1998 dhe 19
12 marsit 1999, këto janë të vetmet dy pika kontrolli që keni
13 parë vetëm e sytë tuaj, apo jo?

14 PË. Jo, nuk është e saktë. Kam parë të tjera. Një shembull
15 sapo ua dhashë.

16 PY. Megjithatë keni ndaluar vetëm në këto dy pika kontrolli
17 vetë, apo jo?

18 PË. Po, me sa më kujtohet.

19 PY. Dëshiroj që të kaloj tek një fushë tjetër.

20 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nëse më lejoni dëshirojmë që të
21 kalojmë në seancë private për pak minuta për ta pyetur lidhur
22 me një person konkret, i nderuar Gjykatës.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

24 Kalojmë në seancë private për të mbrojtur dëshmitarët.

25 [Seancë private]

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20 [Seancë e hapur]

21 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

22 jemi në seancë publike.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

24 Mund të vazhdoni.

25 Z. ROBERTS: [Përkthim]

1 PY. Dëshmitar, në paragrafin 76 të deklaratës tuaj, e kam
2 fjalën për deklaratën që i keni dhënë ZPS-së që është prova
3 materiale 392, ju thoni.

4 "Kam thënë në deklaratën për TPNJ-në, që ndërmjet
5 njerëzve që kemi takuar në Tërpezë kolegu im njohu një person
6 'Dhjetëshin'. Nuk e di në qoftë se 'Dhjetëshi' ishte person
7 apo departament por sigurisht kjo donte të thoshte diçka për
8 kolegun tim".

9 A ju kujtohet ta keni thënë këtë gjë?

10 PË. Po.

11 PY. Në deklaratën e mëhershme për TPNJ-në, versionin paraprak
12 të saj që është prova materiale P407, ju e keni shprehur
13 kështu këtë gjë:

14 "Në Tërpezë -- keni dhënë këtë shpjegim, pra:

15 "Në Tërpezë jeni takuar me disa persona të UÇK-së
16 përfshirë këtu edhe një zotësi që kishte veshur rroba të zeza
17 dhe që kolegu im e njohu si 'Dhjetëshi' përfaqësues i
18 shërbimit të inteligjencës".

19 Dhe, që fundi, në raportin për incidentin e Misionit të
20 Verifikimit të Kosovës, në provën materiale P406, ju
21 përshkruani se kolegu juaj e "njohu dikë, një person pra, një
22 mashkull, një burrë që ishte shefi i operacioneve sekrete të
23 UÇK-së". Për procesverbal ky është dokumenti P406 në
24 dokumentin U00079613.

25 A ju kujtohen këto referenca të ndryshme lidhur me këtë

1 person?

2 PË. Po, përveç referencës në raportin për ngjarjen, që unë
3 nuk e kam parë deri kur mu tregua nga ZPS-ja, nuk më kujtohet
4 ta kem parë në atë kohë, në kohën e ngjarjes. Ka gabime në të
5 mbështetur në intervistën time, në veçanti, me departamentin e
6 ndërlidhjes të MVK-së, Misionin Verifikues të Kosovës. Kështu
7 që shprehja që sapo ju përdorët jo domosdoshmërisht ka ardhur
8 nga unë ose ndoshta mund të ketë qenë një problem
9 interpretimi, përkthimi ose keqpërkthim, keqinterpretim.

10 PY. Keqinterpretim nga kush? Individit, personi që ka shkruar
11 raportin, mund të na e sqaroni?

12 PË. A mund t'i përsërisësh dhe njëherë këto fjalë që ta kem
13 më të qartë

14 PY. Ndoshta do ishte më mirë që ta paraqisnim në ekran këtë
15 dokument.

16 Z. ROBERTS: [Përkthim] Është prova materiale 406. Do i
17 kërkoja Sekretares ta paraqesë në ekran këtë. Është dokument
18 me referencën U0079613. Janë nëntë ose dhjetë rreshta përpara
19 fundit të faqes. Është dokument konfidencial sepse do nxirrte
20 emrin e individit që unë ju referova si kolegu juaj kështu që
21 nuk duhet të paraqitet për publikun.

22 PY. Dëshmitar, në qoftë se e lexoni, po ashtu ju lutem kini
23 parasysh që nuk duhet ta përmendni këtë emër në seancë
24 publike.

25 A e shikoni përpara dokumentin, Dëshmitar? Nëse do të

1 shkonim në fund të faqes është një fjali që thuhet:

2 "Komandanti në Tërpezë ishte Topi. Young nuk njohu askënd
3 por ky (kolegu juaj) ka njohur dikë që ishte shefi i
4 Operacioneve Sekrete të UÇK-së".

5 A e shikoni këtë rresht në raport, Dëshmitar?

6 PË. Po. Megjithatë ka dy persona të ndryshëm që përmenden në
7 këtë raport për incidentin. Është një person sipër, pra, Reti
8 ose Retimja është një vend tjetër, nuk është Tërpezë dhe janë
9 dy vende të ndryshme.

10 PY. Po, keni të drejtë. Po thoni që personi që është
11 identifikuar si Dhjetëshi nuk ka qenë në Tërpezë po në vendin
12 tjetër?

13 PË. Kam përshtypjen që ka një ndoshta mund ta kem gabim, por
14 ka një gabim që lidh Tërpezën me Dhjetëshin. Po jam i sigurt
15 që personi me të cilin kemi folur në Reti --

16 PY. Kolegu juaj?

17 PË. Jo. Përfaqësuesi i UÇK-së me të cilin kemi folur në Reti
18 u identifikua, u vetë identifikua, na tha ne që ai ishte shefi
19 i departamentit të informimit në atë njësit të UÇK-së. Kështu
20 u prezantua ai. Mbështetur në përvojën time të mëparshme në
21 Ballkan nuk e di me të drejtë apo gabimisht e kam lidhur këtë
22 informacion si person që merret me veprimtaritë e
23 inteligjencës. Ky ishte personi që ishte në Reti në fakt.

24 Dhe ndërsa kur shkuam në Tërpezë, në vizitën e parë
25 fizike personale në Tërpezë, kemi takuar persona të tjerë.

1 PY. Ky raport nuk e përmend fare Dhjetëshin, apo jo?

2 PË. Këtë raport nuk e kam shkruar unë. Është mbështetur
3 pjesërisht në një intervistim me gabime, me probleme me mua.

4 PY. Kur thoni në një intervistë "jo shumë të mirë" ose "me
5 probleme me mua" çfarë doni thoni?

6 PË. Intervista fillimin e kishte të vështirë. Bëhej fjalë për
7 një oficere grua kanadeze e cila shoqërohej nga departamenti i
8 të drejtave të njeriut të RC1. Por kjo oficerja e policisë
9 kanadeze, në atë kohë, punonte në departamentin e MUP-it, pra,
10 me fjalë të tjera, departamenti ishte përgjegjës për
11 ndërlidhjen me policinë serbe.

12 Pra, dua të them që në deklaratën time nuk përmendet ky
13 si fakt, domethënë, që kjo oficerja punonte me MUP-in.

14 Megjithatë, duke parë shënimet e mia, në shënimet e mia është
15 e përmendur kjo gjë dhe departamenti i ndërlidhjes së MUP-it
16 është përmendur në disa raste në shënimet e mia.

17 Kështu që qëndrimi im ishte që kur unë erdha tek selia në
18 Rahovec, tek zyrat tona në Rahovec dhe kur po pyetesha sa i
19 takon përfshirjes së UÇK-së dhe kur identifikova vendin e
20 posaçëm vendin konkret në Tërpezë që ishte relativisht afër
21 pozicioneve të MUP-it serb, gjëja e fundit që donim ne ishte
22 që informacioni lidhur me Tërpezën t'i kalohej shpejt MUP-it,
23 sepse kjo do të kishte çuar në përpjekje për të shpëtuar
24 kolegun e tyre të zhdukur. Domethënë, ky ishte shqetësimi im,
25 domethënë, që të mbroja këtë informacion që informacioni të

1 mos i kalonte MUP-it.

2 Kolegët e mi e kishin shumë të vështirë të më bindnin mua
3 që nuk duhej të shqetësohesha për këtë gjë. Dhe ky shqetësimi
4 i imi pati ndikim mbi intervistën. Edhe pse në fund unë
5 pranova që të bashkëpunoja mbasi mora garanci që informacioni
6 nuk do t'i kalohej MUP-it, të paktën kishte një gabim që u
7 reflektua në deklaratë, sepse sigurisht, sikur e thashë atë
8 deklaratë nuk është se e kam parë në atë kohë dhe këtu bëhet
9 fjalë për përmendjen e një personi tjetër që ishte oficeri i
10 ndërlidhjes normal me UÇK-në në nivelin e RCI. Në deklaratë
11 thuhet që ai ishte me neve, po e vërteta është që ai person
12 nuk ishte me neve.

13 PY. Në rregull. Do ta sqarojmë këtë pikë pak më vonë. Ju
14 kërkoj ndjesë që ju ndërpreva pak më përpara, por do t'ju bëj
15 edhe njëherë pyetjen që Dhjetëshi nuk është i përfshirë në
16 raportin tuaj dhe është i përfshirë, në fakt, në deklaratën
17 tuaj që është pjesë e këtij raporti.

18 Z. ROBERTS: [Përkthim] Pra, do kalojmë në faqen U0079617.

19 PY. Me ç'kuptoju unë ky është raport i juaji.

20 Z. ROBERTS: [Përkthim] Do të doja që të shikonim pak
21 fundin e këtij raporti dhe para se që të vazhdojmë me
22 përmbajtjen e raportit, dua që t'ju pyes në qoftë se
23 informacionin e keni dhënë ju apo dikush tjetër?

24 PË. Nuk është raporti im. Në paragrafin e katërt përmendet
25 zëvendës drejtori i CC1.

1 PY. Mirë. Atëhere i takon që ka qenë dikush tjetër. Për të
2 qenë të qartë, ju nuk e dini se çfarë është Dhjetëshi apo
3 çfarë ka qenë Dhjetëshi dhe se ka mënyra të ndryshme sesi
4 është përshkruar Dhjetëshi në deklaratat tuaj, po ashtu edhe
5 ndryshe është pasqyruar edhe në këtë raport. A është e drejtë
6 të thuhet kështu?

7 PË. Po. Termi është përdorur. Këtë e mbaj mend më kujtohet.
8 Por çfarë donte të thoshte Dhjetëshi për mua ishte thjesht
9 hamendeshim asnjë më tepër.

10 PY. E kuptoj. Sikurse e thatë edhe më përpara, thjesht dua të
11 sigurohem që e kuptova drejt atë çfarë thatë. Pra, ju thatë që
12 Dhjetëshi mund kishte qenë në Reti. Mund të kishte qenë në
13 Tërpezë. Nuk jeni të sigurt? Këtë sikur thatë më përpara, apo
14 jo?

15 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kundërshtojmë, të nderuar
16 Gjykatës. Ky është shtrembërim i asaj çfarë tha dëshmitari. Ai
17 tha që referenca është në raport me shefin e policisë sekrete.
18 Nuk i referohen Dhjetëshit po shefin e policisë sekrete.

19 Z. ROBERTS: [Përkthim]

20 PY. A mund të na sqaroni pak, z. Dëshmitar?

21 PË. A e përsërisni dot edhe një herë tjetër pyetjen.

22 PY. Po. Individit i cili në një farë mënyre u lidh me
23 Dhjetëshin nga kolegu juaj a mund të ketë qenë në Reti apo në
24 Tërpezë? Ju nuk jeni i sigurt se ku mund të ketë qenë në Reti
25 apo në Tërpezë, kështu?

1 PË. Mendoj se është më mirë të them që nuk jam i sigurt.

2 Mendoj që ka qenë në Tërpezë, megjithatë nuk jam i sigurt
3 kështu që do jetë e drejtë që të them që nuk jam i sigurt.

4 PY. Kolegu juaj nuk ju tha ndonjë gjë tjetër më tepër lidhur
5 me këtë person, kush ishte ky person ose ky subjekt ky
6 Dhjetëshi.

7 PË. Jo, jo ndonjë gjë që më kujtohet.

8 PY. Dhe ky individ që ishte i lidhur me këtë subjekt nuk
9 është se të është dhënë ndonjë shpjegim tjetër nga kolegu
10 juaj, thjesht ka thënë që e ka parë, apo jo?

11 PË. Po, ka qenë pjesë e takimit ose bisedës por nuk është se
12 ka pasë ndonjë gjë tjetër konkrete specifike të lidhur me të.

13 PY. Besoj se e keni shpjeguar në Shënimin Përgatitor 1, që
14 është në provën materiale P408, se nuk keni pasur mundësi të
15 diskutoni saktësinë e interpretimit me kolegun tuaj. Ju keni
16 thënë që menduat që Dhjetëshi donte të thoshte një departament
17 dhe dikush që ishte i pranishëm ishte në një nivel më lartë.
18 Domethënë, ajo çfarë po mundohem të them është që ju nuk e
19 kishit idenë në qoftë se bëhej fjalë për një person ose
20 departament ose çfarë nënkuptonte Dhjetëshi, apo jo?

21 PË. Po, e saktë. Unë nuk e kam parë shumë kolegun, por vetëm
22 atë ditë kemi qenë bashkë, apo jo. Kam punuar me të, nuk është
23 se kam punuar për shumë kohë.

24 PY. Ditën e fundit që e keni parë atë ka qenë data 9 mars,
25 apo jo?

1 PË. Me sa më kujtohet, po. Ai kishte një anëtar të CC1, por
2 gjithmonë e më tepër duke punuar me ndërlidhje me UÇK-në.

3 PY. Në rregull. Tani do të kalojmë në takimin në Tërpezë. Do
4 flasim për përmbajtjen e takimit në Tërpezë. Në deklaratën e
5 ZPS-së keni folur për Ymer Xhafiqi dhe thoni në deklaratën e
6 ZPS-së që në Randubravë, Skënderi ju kishte thënë lidhur me
7 këtë fletë-arrestin për Xhafiqi dhe ju kishte raportuar juve
8 dhe të gjitha thashethemet e tjera që lidhen me marrjen e
9 Xhafiqit. Ju kujtohet kjo t'ia keni thënë ZPS-së?

10 PË. Po.

11 PY. Por edhe në deklaratën që i keni dhënë TPNJ-së juve i
12 përmendni faktin që keni qenë në Randubravë. A ju kujtohet
13 kjo? Dhe i referoheni Georges Bordet edhe këtu?

14 PË. Po, e saktë.

15 PY. Po nuk e keni përmendur pastaj në deklaratën e ZPS-së,
16 apo jo?

17 PË. Ju kërkoj ndjesë por nuk është se ishte ndonjë hollësi
18 shumë e madhe kjo. Geoges Bordet ishte i pranishëm në atë
19 kohë, ishte sëmure, sikurse ja u shpjegova dje dhe për këtë
20 arsye unë isha bërë ushtrues i detyrës së drejtorit për shkak
21 të problemit të tij shëndetësor. Georges kishte qenë i sëmure,
22 pra, dhe kjo ishte arsyeja pse duhej mbështetur në atë
23 incident serioz.

24 PY. Thjesht po përpigëmi se çfarë ju kujtohet nga ky
25 incident, pra, dëshmia juaj sot këtu është që Bordet ka qenë i

1 pranishëm aty dhe ka ardhur me këtë Maisonneuve?

2 PË. Ka ardhur në të njëjtën kohë, pak a shumë. Me sa duket ka
3 ardhur nga Rahoveci, ndërkohë që unë mendova që do vinte nga
4 Prizreni. Njëri prej tyre ka marrë tjetrin me makinë, nuk e di
5 saktësisht, por të dy kanë qenë të pranishëm. Kanë bërë vetëm
6 një takim atë ditë në Randubravë dhe që në fillim takimi me
7 Skënderin pastaj erdhën me Maisonneuve, Bordet dhe Drini, ka
8 mundësi të kenë ardhur veçmas por ishin të gjithë të pranishëm
9 në të njëjtën kohë.

10 PY. Është dëshmia juaj, në fakt, është dëshmia juaj që Drini
11 udhëzoi Skënderin që t'ju çonte juve në një vend ku mund të
12 takonit Xhafiqi?

13 PË. E saktë. Nuk u përmend ndonjë vendndodhje në atë moment.
14 Ne dëgjuam pjesë të bisedës të UÇK-së dhe kuptuam që do të
15 shkonim drejt veriut, detyra ishte që t'i ndiqnim makinën e
16 Skënderit i cili do të na çonte në vendin ku do mbahej takimi.

17 PY. Kur shkuat në Tërpezë a është zona juaj e zakonshme ku
18 vepronit në CC1, edhe në përgjegjësinë tuaj nëse mund ta them
19 kështu apo ishte zonë diçka e re, vend ku s'kishit qenë?

20 PË. Kjo ishte pjesë brenda zonës së CC1, por zakonisht ne nuk
21 shkonim në atë pjesë të Tërpezës për shkak të postblloqeve që
22 përshkrova më parë.

23 PY. Domethënë, Skënderi ndiqte udhëzimet e Drinit që t'ju
24 dërgonte, pra, në këtë vend që përmendën?

25 PË. E saktë.

- 1 PY. Pastaj kur Drini ju tha që nuk dinte asgjë për rrëmbimin
2 ju nuk e dinit a ishte e vërtetë apo jo, po këtë ju tha ai?
- 3 PË. Kështu. Kam bërë një bisedë të gjatë me Drinin. Ishim
4 vetëm në këtë moment. Ai u prezantua pjesërisht dhe më kërkoi
5 që të prezantohesha nga vija e këto lloj gjërash sepse po
6 pritnim informacione tjera që do vinin nga vende të tjera. Dhe
7 ma bëri të qartë, në fakt, unë i besova për aq sa mund të
8 besohet tek njerëzit në ato lloj rrethanash, po unë i besova
9 që s'kishte të bënte, s'kishte të bënte fare për sa i përket
10 rrëmbimit të këtyre personave të humbur.
- 11 PY. Dhe pas këtij momenti nuk e keni takuar më Drinin, s'e
12 keni parë më, apo kështu?
- 13 PË. Jo, nuk më kujtohet ta kem takuar.
- 14 PY. Dhe më duket se nuk e kishit takuar as më parë pasi
15 kështu thatë edhe dje?
- 16 PË. E saktë.
- 17 PY. Pastaj vazhduat në Tërpezë pasdite a ju kujtohet në çfarë
18 momenti kur keni arrit atje? Pak a shumë, në çfarë ore?
- 19 PË. Nuk më kujtohet saktësisht nuk mund ta them. Por e di që
20 ka qenë mesi i pasdites.
- 21 PY. Në këtë shënime në fletoren tuaj, në bllok, besoj që
22 është P402, keni shënuar që dikush ju ka thënë që Xhafiqi
23 ishte në kontroll të formacionit më të lartë, pra, ju kujtohet
24 që e keni shkruar këtë në fletoren e shënimeve tuaja P402.
- 25 Z. ROBERTS: [Përkthim] Dhe ERN është SPOE00116969.

1 PY. Besoj që e keni përfshirë një pjesë të kësaj në
2 deklaratën që i keni dhënë ZPS-së.

3 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk e di a e kemi përkthimin në
4 anglisht të këtyre por është në deklaratë që është dhënë në
5 qoftë se është më mbarë.

6 PY. Besoj është dorëshkrimi juaj, mendoj që jeni në gjendje
7 ta lexoni dorëshkrimin tuaj.

8 PË. Po. Besoj që kam shkruar fjalët ku thuhet "Njëri është
9 mirë". Besoj që e kam shkruar këtë pas një farë kohe pas
10 detajeve që janë më sipër nga dokumente të policisë lidhur me
11 personin e zhdukur.

12 PY. Dje na thatë që "kontrolli i formimit të lartë" është
13 krijuar që ka të bëjë me juve, pra, që përshkruan termin
14 "ushtarak i veçantë", pra, që është niveli më i lartë pra?

15 PË. Saktë.

16 PY. Dhe nuk e keni shkruar në këtë që ju kishit formim më të
17 lartë?

18 PË. Jo. Ajo që po përbëja është që po interpretoj tani sesi
19 ka hyrë kjo. Është shkruar afër referencave topografike ku
20 kemi qenë ne.

21 PY. Dhe ju keni shkruar këto gjatë takimit të parë besoj?
22 Kështu duhet të ishte, sepse ne gjatë takimit të parë nuk e
23 dini që do bëhej takimi i dytë, kështu që logjikisht duhet ta
24 kni shkruar këtë kur keni qenë aty herën e parë.

25 PË. Po. Do isha besoj i sigurt që kjo është shkruar në njërin

1 prej takimeve në Tërpezë. Mund të jetë ashtu siç thoni ju,
2 takimi i parë. Megjithatë, megjithëse gjatë takimit të dytë
3 kur u takova me komandant Çelikut edhe aty isha me qëndrimin
4 që gjeneral Drini na kishte dhënë qasje tek njeriu, personi në
5 fjalë.

6 PY. Që të përfundoj me këtë termin militar, ushtarak. Formimi
7 i lartë nuk do të thotë detyrimisht niveli më i lartë i një
8 organizate. Do të thotë, që dikush në këtë organizatë po ju
9 jepte informacion. Se ata, në qoftë se, pra, një person,
10 individ ju thotë ju që ata janë në nivelin më të lartë, do të
11 thotë që janë në nivelin më të lartë në zinxhirin komandues.
12 Pra, në qoftë se është dikush nga niveli i batalionit do të
13 thotë që pastaj është në nivelin e brigadës, nga brigada
14 pastaj edhe më lartë në nivelin e zonës.

15 Pra, pyetja ime është që ka të bëjë me deklaratën, nuk e
16 përshkruan atë që po i referohemi?

17 PË. Vetëm kam qenë i vetëdijshëm për një nivel më të lartë
18 mbi komandant Drinin.

19 PY. Po, por këtë informacion nuk jua ka dhënë komandant
20 Drini? Ka qenë dikush tjetër, kushdo qoftë që ka qenë ai keni
21 bërë disa takime në Tërpezë, pra, ajo që po them unë ndoshta
22 ke qenë komandant brigade që u ka dhënë këtë informacion apo
23 një nivel më të ulët, pra dhe kur i referohesh nivelit më të
24 lartë nuk do të thotë Shtabit të Përgjithshëm mund të jetë më
25 poshtë?

1 PË. Po. Dhe mundësia tjetër, shpjegim tjetër mund të jetë, që
2 po më vjen tani, që mund t'i kem marrë këto informacione nga
3 MVK-ja si rezultat i mesazheve që ata kishin marrë. Kërkoj
4 ndjesë që nuk mund të ndihmoj më në hollësi me këtë.

5 PY. Dhe kjo është çështje pra, që të kuptojmë sepse ka ndodhë
6 përpara shumë kohësh dhe të përpiqemi të kuptojmë. Pra, gjatë
7 takimit të dytë jeni kthyer në Tërpezë, më duket, rreth orës
8 10.30, apo jo?

9 PË. Nuk di me saktësi tani orën por ka qenë errësirë.

10 PY. Ka qenë errësirë dhe arritët aty dhe u takuat më një
11 individë dhe pastaj në deklaratën tuaj mendoj që e ke
12 shpjeguar:

13 "...përpara që të largoheshim kuptova që ky person ishte
14 komandanti i lartë i UÇK-së Fatmir Limaj, i quajtur 'Çeliku'?"

15 PË. Po.

16 PY. Kur thoni "përpara që të largoheshim", domethënë, e more
17 vesh këtë informacion pasi u takove me të dhe para që të
18 largoheshe nga Tërpeza, saktë?

19 PË. Po, e kuptove këtë nga kolegu im apo kolegu im bisedoi me
20 mu, ishte pjesë e bisedës mes përkthyesit dhe kolegut që të
21 dytë ishin të pranishëm kur më thanë këtë gjë. Në këto momente
22 kam qenë në makinë.

23 PY. Po, po. kalojmë hap pas hapi sepse është e rëndësishme.

24 Që të jem i qartë, ai nuk u prezantua me emër apo me nofkë?

25 PË. Jo.

1 PY. Dhe në kohën kur po flisnit me të nuk e dinit kush ishte
2 dhe s'e kishit parë më parë?

3 PË. Saktë.

4 PY. Dhe ju nuk flisni shqip besoj, nuk dini shqip?

5 PË. Kuptoja në të kaluarën dhe kuptoj akoma disa fjalë.

6 PY. Takimin që bëtë me këtë individ ishte përmes përkthyesit
7 sepse përmendët që kolegu juaj kishte një përkthyes, apo jo?

8 PË. Po. Është përkthyes që punonte, ishte pjesë e stafit tonë
9 në CC1. E njihja këtë person dhe e dija që ishte
10 jashtëzakonisht kompetentë për këtë lloj pune.

11 PY. Pyetjet sqaruese, takimi nuk po ecte mirë, u kthyet në
12 makinë dhe aty kolegu juaj ju tha që individi në fjalë ishte
13 Çeliku?

14 PË. Po, kështu është. Unë u ktheva në makinë për të marrë,
15 bashkë me dy kolegët. Kolegu nga MVK-ja dhe që t'ju jepja
16 atyre mundësinë që ta provojnë dhe njëherë sepse kishte
17 mosmarrëveshje mes meje dhe përfaqësuesit të UÇK-së me të
18 cilin po bisedonim. Pra, në thelb ai më kishte thënë që unë
19 kisha simpati ndaj serbëve, mbështetja serbët dhe që kisha
20 përmend personin e zhdukur dhe kështu me radhë.

21 PY. Më fal që po ju ndërpres, pyetja kishte të bënte me
22 vendndodhjen ku ishit ju, pra, u kthyet në makinë dhe aty
23 kolegët tuaj ju thanë që ishte Çeliku personi me të cilin
24 biseduan. Dhe atë e kuptuat që ishte e saktë?

25 PË. E saktë.

1 PY. Dhe nuk e dini nëse kolegu ishte takuar me këtë individ
2 më parë?

3 PË. Jo.

4 PY. Dhe nuk e dinin çfarë baze e mori ai këtë informacioni që
5 në bazë të cilit mendoj që ky person ishte Çeliku?

6 PË. Jo. Nuk kam dyshuar informacionin asnjëherë, por nuk e di
7 saktësisht në çfarë baze e dinte ai.

8 PY. Dhe në qoftë se kolegu yt ishte gabim ju s'kishit si ta
9 dinit sepse sipas kësaj s'keni pasë asnjë mundësi që ta
10 bisedoni këtë më shumë pas takimit, pra, sepse ai u largua pak
11 kohë pas takimit?

12 PË. E saktë. Unë u bazova në njohurinë e dy kolegëve të mi,
13 përfshirë edhe përkthyesin që kishte përvojë të madhe.

14 PY. Besoj që keni thënë që nuk e ke parë më këtë individ, nuk
15 jeni kthyer për të parë apo për ta shikuar dhe njëherë për të
16 konfirmuar, është në deklaratën tuaj. Dhe natyrisht nuk keni
17 biseduar me këtë individ apo nuk e keni pyetur në një mënyrë
18 apo një tjetër që të konfirmonte identitetin e tij?

19 PË. Është e saktë duke patur parasysh që kishte tensione mes
20 nesh nuk kishte kuptim që unë të kthehesha tek ai të bisedoja
21 me të. Por mua më ishte dhënë detyra që të merrja një emër dhe
22 kjo ishte puna ime.

23 PY. Në deklaratën tuaj keni thënë që keni vlerësuar që ishit
24 i udhëzuar që të merrnit një emër, të siguronit, të gjenit një
25 emër?

1 PË. Kështu është.

2 PY. Unë do t'ju thoja që në moment që keni marrë këtë emër,
3 nuk keni parë të arsyeshme të ndërmerrni hapat e tjerë për të
4 verifikuar këtë gjë. Morët emrin, e kishit në kokë dhe këtë
5 emër ua dha kolegu juaj, por ti nuk ndërmorët hapa të tjerë
6 për ta verifikuar që ky emër ishte i saktë?

7 PË. Është e saktë. Faktori tjetër ishte shqetësimi im, siç e
8 thashë, se po ishim përballë një personi që nuk ishte nën
9 kontrollin e Drinit, dikush për të cilin kisha dëgjuar dhe
10 kisha dëgjuar për të, pra, ishte një shqetësim që lidhej me
11 sigurinë në këtë moment.

12 PY. Nuk është kritikë. Thjesht po përpiqemi të kuptojmë se
13 për çfarë mund të jepni dëshmi në qoftë se mund ta them
14 kështu.

15 Dhe besoj që gjatë kësaj keni dëshmuar që gjatë këtij
16 takimi ky individ kishte thënë se ishte në nivelin, Xhafiqi
17 ishte në nivelin e lartë të formacioneve, pra?

18 PË. Po.

19 PY. Dhe natyrisht që nuk flisni shqip nuk e dini saktësisht
20 çfarë termi është përdorur në këtë fjalë?

21 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kundërshtim. Ai tha është
22 shtrembërim i deklaratës, sepse thotë kontroll i shtabit NG
23 për të cilin dëshmitari dha dëshmi të drejtpërdrejtë që është
24 Shtabi i Përgjithshëm.

25 Z. ROBERTS: [Përkthim] Pyetje:

1 "...nëse ju nuk dini shqip ju nuk mund ta dini se për
2 çfarë është përdorur kjo"?

3 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kërkoj ndjesë, po në qoftë se
4 kundërshtimi nuk ishte i qartë. Por po përdorëshin fjalë të
5 "Formacioneve më të larta, niveleve më të larta".

6 Z. ROBERTS: [Përkthim]

7 PY. Pra, ju nuk dini shqip dhe nuk e dini cili term është
8 përdorur nga ky individ, cilin term ka përdorur ky individ në
9 shqip.

10 PË. Më kujtohet që, besoj që më kujtohet fjalë i ka shënuar
11 fjalët "shtabi" apo një fjalë të ngjashme me këtë shtab.
12 Kuptoja shqip në nivel mjaftueshëm për të kapur fjalë këtu
13 atje dhe kur flisja me banorët vendorë shqiptarë apo serbë
14 dija mjaftueshëm për të kuptuar natyrën e bisedës dhe
15 ndonjëherë për të kuptuar ndonjë fjalë që ndoshta nuk më
16 përkthehej.

17 PY. Në qoftë se ju them që fjala "shtab" do të thotë staf,
18 shtab, por nuk ka dallim mes shtabit të lartë, nivelit të
19 lartë të komandës apo nivelit të ulët, do pajtoheshit me mua
20 apo jo?

21 PË. Nuk mund të mos pajtohem me këtë. Unë po bazohesha
22 kryesisht në gjuhën angleze dhe përkthimin që më jepej, po siç
23 e bëj zakonisht. Po kësaj radhe, me një përkthyes me përvojë
24 të madhe, ndoqa me vëmendje atë që po thuhej për të pasur një
25 aftësi gjykimi që ajo që po më thuhej ishte e saktë.

1 PY. Dhe ju i keni deklaruar ZPS-së në seancën përgatitore
2 numër 1, 408, paragrafi 17, kur u takuat me këtë person
3 kuptuat që ai po fliste në emër të Shtabit të Përgjithshëm.
4 Mund citoj fjalët e juaja, siç janë regjistruar shënuar aty,
5 në qoftë se dëshironi. Në qoftë se kjo mund t'ju ndihmojë më
6 shumë mund t'ju lexoj paragrafin 17:

7 "Nga dëshmitari qartësoj se në atë kohë ku takoj Çelikun
8 kuptohet që ai po fliste në emër të Shtabit të Përgjithshëm".
9 PË. Kështu është. Saktë. Do të ishte e ekzagjeruar të thuhej
10 që e dija në momentin kur kam arritur aty që kjo u bë e qartë
11 nga ajo që thuhej sepse unë vazhdova t'i thoja atij që
12 komandant Drini kishte urdhëruar. Dhe nuk jam i sigurt që do
13 të isha mbështetur kaq shumë në këtë po ta kisha ditur që në
14 fillim që ky person po fliste në fakt në emër të niveleve më
15 të larta.

16 PY. Ajo që po them unë është që, ashtu siç e keni nënkuptuar
17 ju, është interpretimi juaj i bisedës së përkthyer me një
18 individ që me të cilin nuk ishit takuar më parë?

19 PË. Ai na tha që personi ishte në kontrollin e Shtabit të
20 Përgjithshëm. Kjo u tha. Jam i sigurt për këtë. Dhe nuk mund
21 t'ju jap hollësi lidhur me fjalët që u thanë në këtë bisedë
22 por ajo çka po transmetonte apo që besoj se po transmetonte.

23 Si informacion thjeshtë jo në emër të, po qartësisht po
24 thonte që personi në fjalë ishte nën kontrollin e Shtabit të
25 Përgjithshëm dhe për rrjedhojë negociatat e mia të përparme me

1 komandant Drinin nuk kishin më vlerë se bëhej fjalë për nivele
2 më të larta këtu.

3 PY. Që të përfundojmë me këtë pjesë. Besoj se në deklaratën
4 tuaj keni pranuar që Shtabi i Përgjithshëm kishte mohuar që
5 kishte kontroll të njëkohësishëm në të njëjtën datë? Paragrafi
6 80. Dhe mund të lexoj deklaratën tuaj në qoftë se kjo ju
7 ndihmon:

8 "Në shënimet e mia, kam shënuar ... disa pika lidhur me
9 rrëmbimin, përfshirë dhe 'mohimin e Shtabit të Përgjithshëm
10 për përfshirjen e tyre' ...".

11 Ju kujtohet kjo deklaratë që i keni dhënë ZPS-së?

12 PË. Nuk më kujtohet se në cilin moment ose nga vjen kjo.

13 PY. Ajo që po them është që ka patur informacione
14 kundërthënëse, në qoftë se mund ta përdorë këtë fjali, një
15 individ i paidentifikuar me të cilin ishit takuar në Tërpezë
16 se ky individ pretendohet të ishte nën kontrollin e Shtabit të
17 Përgjithshëm, po në të njëjtën kohë Shtabi i Përgjithshëm
18 mohon që e kishin ata këtë person?

19 PË. Kërkoj ndjesë që nuk jam në gjendje ta sqaroj këtë, por
20 nuk më kujtohet se në cilin moment të ditës apo në cilën orë
21 më është thënë kjo. Mendoj që mund të jetë thënë MVK-së e cila
22 pastaj ma ka transmetuar mua.

23 PY. Po besoj që ju keni menduar që kjo mund të vinte nga
24 dikush në nivele të larta të MVK-së apo misioni i SHBA-së Zyra
25 e Pavarur Ndërlidhëse me UÇK-në, a ju kujtohet që i keni thënë

1 këtë ZPS-së?

2 PË. Mendoj që në qoftë se është e mundur që shohim deklaratën
3 siç e kam thënë natyrisht.

4 Z. ROBERTS: [Përkthim] Në qoftë se mund të shfaqim në
5 ekran paragrafin 80, dokumentit të shënuar P392. Për
6 procesverbal, kjo është 085962, faqja 21. Kërkoj ndjesë, nuk e
7 kam referencën në gjuhën shqipe, por dëshmitari do të lexoj
8 paragrafin në anglisht. A e shihni paragrafin 80, z.
9 Dëshmitar, në ekran?

10 PË. Po. Faleminderit. Kjo më ndihmon në fakt. Aty ku thotë që
11 "Shtabi i Përgjithshëm mohoi" dikush në nivel të lartë. Besoj
12 që kjo i referohet raportit që mora kur erdha në shtabin tonë,
13 do raporte që mu dhanë nga Georges Bordet bazuar në
14 ndërlidhjen e tij me z. Maisonneuve.

15 PY. Kjo është në mbrëmje pasi u kthyet?

16 PË. Pasi u ktheva nga takimi i parë në mbrëmje.

17 PY. Pra, kishit dy informacione kundërthënëse nga po të
18 njëjtën ditë, një nga Bordet, eprori juaj dhe një ajo që
19 kuptuat ju nëse Shtabi i Përgjithshëm kishte pranuar ndonjë
20 lloj kontrolli të Xhafiqit?

21 PË. Kjo është logjika. Unë po ndiqja udhëzimet e gjeneral
22 Drinit. Të cilat përputhen me raportin që më dha Georges
23 Bordet të shënuara në fletoren time. Pastaj shkova në takimin
24 e dytë në Tërpezë mbi bazën se po veproj akoma nën autoritetin
25 dhe udhëzimet e komandant Drinit. Dhe në atë moment, gabimisht

1 apo me të drejtë, personi me të cilin u takova herën e dytë në
2 Tërpezë tha që "tani e kishte tejkaluar këtë nivel" dhe
3 personi në fjalë "ishte nën kontrollin e Shtabit të
4 Përgjithshëm". Deri në atë moment, qëndrimi im ishte që Shtabi
5 i Përgjithshëm kishte mohuar kontrollin, ashtu siç kishte bërë
6 dhe komandant Drini.

7 PY. Që të përfundojmë me këtë pikë dhe, në fakt, përfundoj
8 dhe me pyetjet e mia. Në shënimet në bllokun tuaj e vetmja gjë
9 që keni shënuar për ndërveprimet që keni patur me këtë
10 komandantin që e quanin Çelik është fjala "Çelik" që pastaj
11 është u rënë vizë.

12 Z. ROBERTS: [Përkthim] Është në faqen P402 dhe ERN që në
13 qoftë se mund t'ia tregojmë dëshmitarit në ekran që ta
14 ndihmosh SPOE00116971

15 PY. Dhe besoj që i keni deklaruar ZPS-së se nuk e dinit pse i
16 është rënë vizë kësaj fjale?

17 PË. E saktë. Nuk kam dyshuar në asnjë moment që kush ishte ky
18 person, tani pavarësisht a ishte informacion i saktë apo jo
19 unë s'kisha asnjë dyshim që isha takuar me këtë person.

20 PY. Pra, ju nuk kishit dyshim se ishte personi të cilit ju
21 kishin thënë që ishte?

22 PË. Besoj që është më shumë se kaq, sepse kisha paraprakisht
23 njohuri për llojin e operacioneve që personi në fjalë në të
24 cilat ishte përfshirë më parë, pra nuk ishte thjeshtë çështje
25 që më ishte thënë një emër. Ishte emri përputhej me njohuritë

1 që kisha më parë. Dhe paraqitja e tij ishte në përputhje me
2 një fotografi të mëhershme që kisha parë, por e theksoj, nuk
3 po bëj këtu identifikim fotografik por thjeshtë e kisha parë
4 një fotografi e cila ishte në përputhje me personin që u
5 shfaq.

6 Z. ROBERTS: [Përkthim] Shpresoj që të mos ishin zorrët e
7 mia.

8 PY. Që të përfundojmë me mënyrën sesi u përshkrua ky individ
9 në raportin që pamë më herët.

10 Z. ROBERTS: [Përkthim] Në qoftë se mund të kthehemi në
11 raportin e incidentit të përpiluar nga MVK-ja në Kosovë. P406.
12 Në U007-9614. Ju lutem.

13 Pak më poshtë ju lutem.

14 PY. Aty ku shënon "UM3". Mendoj që "UM3" do të thotë
15 "mashkulli numër 3 i paidentifikuar". A mund ta konfirmoni
16 këtë? Kuptoj që s'e keni shkruar, përpiluar këtë raport, po a
17 e kuptoni dhe ju kështu?

18 PË. Po.

19 PY. Dhe aty shkruan që ky individ u përpoq të justifikonte
20 çfarë kishte bërë UÇK-ja. Dukej që dinte për rastin:

21 "Ky UVMK u largua pas orës 23.00 pa parë Xhafiqi".

22 Pra, ka përshkrim të UM2 dhe UM por nuk ka tjetër
23 informacion që u është dhënë në atë kohë me sa duket në bazë
24 të informacionit që i keni dhënë individit që ka bërë këtë
25 raport që do të na ndihmonte në konfirmimin e identifikimit të

1 individit?

2 PË. Nuk më është kërkuar përshkrim gjatë kësaj interviste, me
3 sa më kujtohet dhe, siç e kam përshkruar, ka qenë një
4 intervistë pak më ndryshe dhe s'kishim shumë kohë.

5 Z. ROBERTS: [Përkthim] Faleminderit, Z. Gjykatës këto
6 ishin pyetjet e mia, s'kam me pyetje.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetiç.

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, Kryegjykatës.

9 Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç:

10 Z. MISETIC: [Përkthim]

11 PY. Mirëmëngjes, z. Young. Unë quhem Luka Misetiç. Jam një
12 nga avokatët e z. Thaçi. Kam vetëm disa pyetje. Shpresoj të
13 përfundojmë para se të marrim pushimin e kafes në orën 11.00.
14 Kam disa aspekte që duam të trajtojmë së bashku.

15 Pyetja ime e parë është a njihni një person me emrin
16 Nicholas apo Nick Turnbull?

17 PË. Jo.

18 PY. Do ju ndihmoja në qoftë se do ju thoja Nick Turnbull ka
19 qenë shefi i KDOM-it të BE-së gjatë kohës që keni qenë ju
20 atje?

21 PË. Jo. S'kam pasur shumë lidhje me KDOM-in e BE-së. Mbaj
22 mend pak në fillimet e veta po nuk kam pasë ndonjë marrëdhënie
23 personale me ta.

24 PY. Do ju bëj një pyetje tjetër. Z. Roberts, ju pyeti për
25 takimin në Tërpezë dhe ju kujtohet që ju tregoi dhe shënimet

14 PY. Dhe më vonë u promovua, u ngrit në detyrë si gjeneral i
15 forcës tokësore në Kanada, apo jo?

16 PË. Po.

17 PY. Ndër dokumentet që ka dorëzuar, që ka treguar -- më jepni
18 një çast.

19 Z. EMMERSON: [Përkthim] Është dokumenti me numër ERN IT-
20 05-87 -- Ju kërkoh ndjesë, është propozuar si provë materiale
21 dhe ka numrin P02772. Mendoj që është faqja e parë në mos
22 gabohem, kjo që kemi përpara ekranit. Nëse mundeni le të
23 kalojmë te faqja tjetër, te faqja e dytë. Po kjo faqe.

24 PY. Kjo është deklarata e dëshmitarit që ka bërë ai, që
25 pasqyron disa prej dokumenteve të asaj kohe, të cilat do t'i

1 shikojmë më pas bashkë.

2 Z. EMMERSON: [Përkthim] A mund të shikojmë në faqen 27 të
3 deklaratës së dëshmitarit.

4 PY. Ky është një raport i asaj kohe nga Qendra Rajonale nr.
5 1, data është 23 shkurt i vitit 1999, ndërkohë që keni qenë në
6 shërbim. Pra të zhvendosur atje, të dislokuar atje. Dhe ka të
7 bëjë me zbatimin e masave ndërlidhëse. Në këtë kontekst, masat
8 ndërlidhëse nënkuptojnë aftësinë për të marrë informacion
9 përmes të folur të drejtpërdrejtë ose me pjesëmarrësit në
10 konflikt ose dëshmitarë që ishin të pranishëm në raste të
11 caktuara, në incidente të caktuara. A është përshkrim i saktë
12 ky?

13 PË. Po.

14 PY. Më pas jepet një përmbledhje e asaj çfarë njihej ose
15 dihej në atë kohë nga MVK-ja lidhur me palët e ndryshme në
16 konflikt dhe sa e vështirë apo e lehtë ishte që të
17 ndërlidheshe ose që të komunikojë me ta. Nëse do shikojmë
18 paragrafin 4a, jepet një përshkrim në këtë paragraf. Është
19 përshkrimi i UÇK-së, pra duket sikur jepet një vlerësim i
20 përgjithshëm në paragrafin a dhe thuhet e përgjithshme, çka do
21 të thotë që është vlerësim i përgjithshëm. Më tej thuhet që:

22 "Potencialisht më i vështiri për t'u monitoruar sa i
23 takon ndërlidhjes dhe konfirmimit të përmbushjes për shkak të
24 mungesës së hollësive konkrete, të lidhura me strukturën
25 vendet, dhe aftësitë e organizatës."

1 A e shikoni këtë pjesë? A pajtoheni që ky është vlerësimi
2 i organizatës tuaj, domethënë që ishte shumë e vështirë për ju
3 si organizatë që të vlerësonit aftësitë e UÇK-së si dhe
4 strukturat e saj? Kështu?

5 PË. Po.

6 PY. Vazhdon më tej teksti duke thënë që

7 "Aspektet e përgjithshme dhe panorama deri tani është e
8 pamjaftueshme që të krijosh një ide të përshtatshme lidhur me
9 aftësinë komunikuese. Megjithatë, në qoftë se UÇK-ja dëshiron
10 që të njihet si një forcë e besueshme dhe legjitime, ajo duhet
11 të inkurajohet që të jetë më aksesueshme, më e qasshme për të
12 tjerët."

13 Vijohet më tej që RC është akronimi i qendrës rajonale,
14 domethënë i gjithë qendrave rajonale, kështu?

15 PË. Po.

16 PY. Pastaj thuhet "RC, UÇK, LO, ose oficerët e ndërlidhjes së
17 UÇK-së, do të jenë përgjegjës për bashkërendimin ose mbledhjen
18 e informacionit."

19 Përsëri mendoj se ky vlerësim i përgjithshëm ka ardhur si
20 rezultat i shumë komponentëve të misionëve monitorues, apo jo.
21 Si rregull kështu duhet të ketë qenë. Pra misionëve të
22 ndryshme monitoruese në zonën tonë. Është e drejtë kjo të
23 thuhet?

24 PË. Po.

25 PY. A mund të them atëherë që ju pajtoheni me mua se një prej

1 vështirësive të ndërlihdjes apo të komunikimit ishte që ju nuk
2 kishit informacion të mjaftueshëm lidhur me strukturën e UÇK-
3 së apo nuk e dinit se ku gjendeshin personat që donit që të
4 flisnit ju me ta, apo nuk kishte aftësi të mjaftueshme UÇK-ja
5 dhe që këto ishin një element që cenonin apo ndikonin
6 negativisht në mënyrë të konsiderueshme mbi punën tuaj, apo
7 jo?

8 PË. Po, pjesë e vështirësisë ishte sa i takon pikave të
9 kontaktit që ku takoheshim me ta, ku të -- ku ishte vendi për
10 t'u takuar. Ata kanë caktuar një pikë kontakti permanent ose
11 të përhershëm të kontaktit, të paktën me aq sa dija unë, që
12 ishte një pikë kontakti i UÇK-së në Krushë të Madhe, dhe jo
13 domosdoshmërisht ky person na jepte informacionin e duhur, ose
14 informacion të përshtatshëm. Gjithsesi, kolegë të tjerë të mi
15 kanë shkuar shumë herë më tepër në atë vend për ndërlihdje se
16 sa unë.

17 Megjithatë, duke marrë parasysh terrenin gjeografik,
18 ishte e rëndësishme për ne që të dinim që të shkonim në një
19 zonë të caktuar që të flisnim me personat që kishin
20 kompetencën e duhur nga UÇK-ja. Kështu që pa diskutim që nuk
21 mund të krahasoheshin këto të dyja me njëra tjetrën.
22 Domethënë, aftësia e komunikimit ndërmjet -- me UÇK-në dhe
23 MUP-in, por për ne, domethënë ishte e rëndësishme që të bënim
24 përpjekje të njëjta me UÇK-në për të ndërtuar besimin dhe për
25 të komunikuar. Por për shkak të aspekteve gjeografikë dhe

1 aspekteve të tjerë ishte shumë e vështirë me ta.

2 PY. Besoj që sapo thatë, nuk e di nëse s'të kuptova drejtë

3 apo jo, por më korrigjoni në qoftë se nuk e kam kuptuar drejtë

4 që ju nuk kishit ndonjë godinë, ndonjë ndërtesë, ku mund të

5 takoheshit në male me UÇK-në, apo jo? Këtë thatë?

6 PË. Po në rastin më të madh të rasteve -- rastet më

7 dërrmuese, pra ishte e vështirë për neve që të vendosnim

8 kontaktet. Takoheshim me ta në bjeshkë.

9 PY. Personi përgjegjës për ndërlidhjen ose komunikimin në atë

10 kohë do ishte oficeri kryesor i ndërlidhjes tua, David Wilson,

11 apo jo? Përgjegjësia kryesore ishte e tija, apo jo?

12 PË. Po. Ishte nën kompetencën e tij. Personalisht, edhe pse e

13 njihja Davidin, unë nuk e kam parë që ai të jetë përfshirë në

14 gjëra të tilla. Nuk është se kam dyshim se ai është

15 përfshirë. Megjithatë, personi me të cilin ai është takuar më

16 shpesh është Andrew Strong [sipas përkthimit]. Për sa i takon

17 aspektit të ndërlidhjes.

18 PY. Dëshmitar, ju lutem më lini të vazhdoj --

19 PË. Chris Cobb Smith, me atë ka punuar, por Chris Cobb-Smith

20 ka pasur edhe punë të tjera në atë kohë.

21 PY. Edhe Chris-Cobb Smith edhe personi tjetër, këtë

22 informacion -- ky Andy Lefever, informacionin ja jepnin David

23 Wilson, se David Wilson ishte epror mbi ta apo jo?

24 PË. Po.

25 Z. EMMERSON: [Përkthim] Të shohim faqen 47 nga i njëjti

1 dokument. Janë shënime të mbajtura në atë kohë. Mund t'i
2 shohim për një çast, t'i shikojmë datat bashkë, por është
3 rishikuar dhe ka qenë një dokument i cili është shkruar dhe ka
4 pasqyruar edhe ndryshimet përkatëse. Domethënë, është shkruar
5 fillimisht, dhe pastaj është përditësuar në fillim të
6 dhjetorit, dhe më pas në dhjetor. Pra ky është versioni i
7 datës 27 dhjetor.

8 Do kërkoja që të fillojnë me paragrafin 1. Pra dëshiroj
9 që të shikoni këtë paragraf të parë për t'ju kujtuar ju
10 natyrën e këtij dokumentin që kishte disa versione. Pra ishte
11 një dokument që ndryshonte sipas zhvillimeve.

12

13 PY. Pra, është një dokument që e ka zanafillën në pjesën e
14 parë të KDOM-it britanik në Prizren, që ka të bëjë me njësinë
15 tuaj.

16 PË. Po, është një dokument që ngre disa çështje, por sikurse
17 dhe mund ta shihni edhe vetë, në të thuhet që origjina ka qenë
18 në pjesën e hershme të KDOM-it britanik në Prizren. Flas për
19 origjinën e këtij dokumenti.

20 Versioni i parë është shkruar më 22 nëntor të vitit 1998
21 për KDOM-in britanik dhe më pas është përditësuar dhe
22 ndryshuar pak më datë 6 dhjetor 1998, për të ndihmuar me
23 orientimin e fluksit fillestar të verifikuesit të OSBE-së, ku
24 ke qenë pjesë edhe ti. I takon që një prej verifikuesve që ka
25 përfituar nga ky dokument. Vijohet më tej në tekst dhe thuhet

1 që është përditësuar ose është rishikuar më tej më 27 dhjetor
2 1998 dhe ky është versioni që po shikojmë, ky është raporti i
3 përditësuar.

4 Është versioni i raportit që mban datën 27 dhjetor. Edhe
5 pse thotë që:

6 "Edhe pse pjesa më e madhe e informacionit mbeti e
7 pandryshuar, ka gjithsesi korrigjime të vogla dhe analiza të
8 rishikuara, mbështetur në informacion më të vonë, ose më të
9 freskët."

10 A mund të themi që ne po shohim një përmbledhje të
11 shkurtër të asaj çfarë dinte KDOM-i lidhur me këtë gamën e
12 gjerë të çështje shqetësuese që ekzistonin në Prizren? Besoj
13 se e keni parë dokumentin në një fazë të caktuar kur jeni
14 trajnuar fillimisht para se të shkonit në Kosovë. besoj se po,
15 apo jo?

16 PË. Besoj se e kam parë. Informacion që shikoj këtu më duket
17 i saktë mua, më duket i kuptueshëm sa i takon zhvillimeve të
18 situatës në atë kohë.

19 PY. Po, dhe mendoj që ju keni qenë një prej fluksit fillestar
20 të verifikuesve të OSBE-së. Është e saktë apo jo?

21 PË. Po, po unë kam qenë aty, kam qenë si pjesë e KDOM-it,
22 isha aty si pjesë e KDOM-it britanik.

23 PY. Në rastin tuaj nuk është se nuk dihej gjë fare për
24 situatën. Domethënë është -- mendoj se është -- se mund të
25 ketë qenë një dokument pune që mbase e keni parë dhe më herët.

1 PË. Nuk më kujtohet konkretisht ky dokument, nuk mund të them
2 dot as po, as jo. Ndërkohë që kam parë në fakt raporte të
3 ndryshme të shkruara nga oficerë --

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Mayer?

5 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Thjeshtë do të doja të thosha që
6 në fund të paragrafit ka një specifikim që mbase mund ta
7 ndihmojë dëshmitarin për të thënë në qoftë se e ka parë këtë
8 raport apo jo, sepse thuhet që:

9 "Është një dokument i OSBE-së, është një dokument i cili
10 është shkruar nga David Wilson."

11 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po, është një dokument personal.
12 Është shkruar nga David Wilson.

13 "Është një kopje që është dhënë pa lejen e tij."

14 Por është absolutisht e qartë që është përdorur për të
15 informuar njerëzit përpara se sa të futeshin në Kosovë.

16 PY. Nuk është kështu, apo jo?

17 PË. Nuk e di kujt i është dhënë ky raport, kujt i është
18 shpërndarë ky raport.

19 PY. Në rregull. Po të paktën ai e ka shkruar.

20 PË. Po, e ka shkruar ai.

21 PY. Dhe ai ishte dikush që ishte përgjegjës për komunikimin
22 apo ndërlihdjen? Kishte një staf, personel të vetin, dhe që
23 ishte përgjegjës për z. Maisonneuve?

24 PË. Po.

25 Z. EMMERSON: [Përkthim] Atëherë do shikojmë, do ju

1 lutesha, paragrafin 15. Sa i takon dokumentit, faqja është
2 K0075660. Kjo është faqja.
3 PY. Besoj që shikoni në krye të faqes që jepet një
4 përmbledhje, një përshkrim i UÇK-së. Jepen disa sugjerime dhe
5 disa kategorizime të elementëve të luftës, apo të luftimeve.
6 Dua ta shohim bashkë dhe do t'ju pyes në qoftë se pasqyrimi i
7 z. Wilson përkon me mënyrën se si e keni kuptuar ju situatën
8 atëherë, duke marrë parasysh edhe specifikat e organizatës për
9 të cilën punoni ju. Ai thotë:

10 "Viti 1998 ka qenë një vit i vështirë për UÇK-në.
11 Sukseset ushtarake të tyre në periudhën mars deri në korrik të
12 vitit 1998 i kanë çuditur të gjithë, përfshirë edhe veten e
13 tyre. Të prekur lehtësisht nga niveli i arritjeve të tyre të
14 hershme, së bashku me mungesën e përgjigjes efektive të
15 autoriteteve të ish-Jugosllavisë, ata u shtrinë më shumë seç
16 duhet."

17 Domethënë, ky është vlerësimi që bëhet për UÇK-në përpara
18 se sa të dislokoheshit ju. Ky është informacioni që e vënë në
19 dispozicion besoj. A jeni dakord, a pajtoheni?

20 PË. Po, ngjarjet e vitit 1998 i kanë lënë disi në hije
21 operacionet tona, ose veprimet tona. Pra, Rahoveci pjesërisht
22 ishte marrë nga UÇK-ja, por edhe Malisheva. Ishte bërë goxha
23 përparim nga UÇK-ja, sa i takon Malishevës, ku kishte edhe një
24 prani të shtabit. Kështu që ngjarjet e të ashtuquajturës
25 ofensivë ishin goxha të njohura.

1 PY. Kolonel Crosland a ju dërgoi në atë zonë juve? Apo a
2 diskutoi me ju se çfarë kishte ndodhur në Rahovec? A ju dërgoi
3 në zonë, apo diskutoi me ju se çfarë kishte ndodhur në
4 Rahovec?

5 PË. Mendoj që me siguri i ka diskutuar këto ngjarje.
6 Megjithatë nuk më kujtohet që John Crosland të më ketë çuar
7 fizikisht në Rahovec. Hera e parë që kam shkuar atje kam qenë
8 me një koleg timin që ishte një prej verifikuesve të posaçëm.

9 PY. Dhe besoj që ju bëri me dije ju, pra deri sa ju ishit
10 pjesë e MVK-së në Prizren, ju bëri me dije, ose ju tregoi për
11 ofensivën serbe që kishte ngjarë në korrik, apo sulmi serb që
12 kishte ngjarë, kishte ndodhur në korrik në përgjigje të disa
13 ushtarëve të UÇK-së që ishin gjetur brenda Rahovecit. Besoj se
14 ua ka thënë këtë gjë, apo jo?

15 PË. Po, po, besoj që situata ishte shumë më tepër dramatike
16 se sa kjo që përshkruat që ishin gjetur ca ushtarë të UÇK-së
17 në Rahovec.

18 PY. Po, po. Domethënë ishte filluar nga sulmi nga prania e
19 UÇK-së?

20 PË. Pastaj ishte përgjigja [e pakuptueshme] ose
21 kundërpërgjigja e serbëve.

22 PY. A ju tregoi ai se çfarë kishte parë, çfarë kishte ngjarë,
23 çfarë kishte ndodhur, cilat ishin pasojat e menjëhershme të
24 atij sulmi?

25 PË. Nuk më kujtohet çfarë më ka thënë konkretisht John

1 Crosland, por sigurisht që kam dëgjuar nga shumë njerëz, nga
2 vendas, nga persona të ndryshëm, nga burime të ndryshëm se
3 çfarë kishte ndodhur në atë kohë. Nga shumë burime e kam
4 dëgjuar këtë gjë.

5 PY. Ai, ose ndonjë burim tjetër, a ju ka dhënë ndonjë
6 vlerësim ose a ju ka thënë që ka qindra -- dhjetëra -- qindra
7 shqiptarë të cilët ishin zhdukur, si rezultat i zhvendosjes në
8 atë zonë?

9 PË. Kam dëgjuar, jam i sigurt, shumë shifra. E di që shumë
10 veta ishin dëbuar, ishin larguar nga shtëpitë, kishin shkuar
11 në male, kishin -- ishin -- kishin shkuar në drejtime të
12 ndryshme. Sigurisht që e kam dëgjuar që kishte më shumë
13 persona të tillë shqiptarë të tillë zhvendosur, në një formë
14 ose një tjetër gjatë asaj kohe.

15 PY. Kalojmë te paragrafi 15. Pra të pasurit të një panorame
16 të sukseseve relativisht të hershme në periudhën mars-korrik,
17 vjen përgjigja. Dokumenti thotë si më poshtë:

18 "Kur autoritetet e ish-Jugosllavisë sulmuan, ata i
19 luftuan -- e luftuan UÇK-në lehtësisht duke ekspozuar dobësi
20 thelbësore ose të mëdha sa i takon trajnimit të tyre,
21 pajisjeve dhe C-së."

22 Çfarë është C-ja e mund të na e thoni?

23 PË. Po, C-ja është komanda dhe kontrolli.

24 PY. Në rregull. Domethënë, kjo është regjistruar dhe i është
25 thënë kolegëve të tu, verifikuesve që vinin, pra që kishte

1 dobësi thelbësorë, dobësi të mëdha sa i takonte komandës dhe
2 kontrollit, apo jo?

3 PË. Po.

4 PY. Vijon më tej raporti dhe thotë që:

5 "Në veçanti, përpjekjet e UÇK-së për të mbajtur terrenin
6 me këmbësorinë jo mirë të pajisur, sigurisht iu has me një
7 oponent, se kundërshtar që ishte shumë mirë i armatosur dhe i
8 organizuar."

9 Ju kërkoj ndjesë, por e lexoj edhe në herë tjetër:

10 "Në veçanti përpjekjet e UÇK-së për të mbajtur pozicionet
11 e fituara me këmbësori jo të pajisur mirë, kundrejt një
12 kundërshtar të mirë armatosur dhe të organizuar, nuk mund të
13 kishin ndonjë fat tjetër por të dështonin. Në të njëjtën kohë,
14 media ndërkombëtare prodhoi disa raporte konsistente për UÇK-
15 në që nuk ishte gjë tjetër vetëm si një lëvdim i UÇK-së.
16 Megjithatë, në veçanti, mungesa e lidhjes politike dhe
17 pavarësia në dukje e komandantëve lokalë, cilësia e varfër e
18 zëdhënësve të tyre dhe të tjerë."

19 Domethënë, dua të ndaloj këtu, në këtë paragraf. [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 [REDAKTUAR]

22 [REDAKTUAR]. Megjithatë, pyetja për ju është kjo

23 që ky ishte personi që e ka bërë infiltrimin e informacionit
24 përpara se sa të bëhej organizimi juaj. Domethënë, ky është
25 raporti, kjo ishte gjendja e reflektuar në raport gjatë kohës

1 tuaj, ose në fillim të kohës kur keni shkuar në Kosovë. dhe
2 në fund, më datë 28 dhjetor të vitit 1999 [sipas përkthimit],
3 ose në pararendje të ngjarjeve të vitit 1999.

4 A nuk pajtoheni me këtë vlerësim? Çfarë mendimi keni?

5 PË. Nuk ishte e njëjta situatë gjithandej. Gjërat ishin më të
6 organizuara në disa vende dhe më pak të organizuara në vende
7 të tjera. Kur lexoj këtë paragraf më kujtohet një ditë që
8 ishte goxha herët. Nuk kisha shumë që isha zhvendosur, që isha
9 dislokuar atje, kur po shikoja -- po shoqëroja një nga
10 anëtarët e BBC-së që dëshironte që të intervistonte MUP-in dhe
11 UÇK-në. Fillimisht e dërgova te MUP-i ku ata u treguan të
12 sjellshëm por nuk i dhanë intervistë, e refuzuan intervistën e
13 tij. Dhe më pas e dërgova për t'u takuar me UÇK-në. Nuk është
14 se ishte bërë ndonjë organizim të më hershëm, por e dija që
15 UÇK-ja do të ishte në një zonë të caktuar dhe ai dëshironte që
16 të merrte ca pamje filmike të UÇK-së. Dhe në fakt kjo ishte
17 njëra prej pikave të kontrollit ku ne nuk patëm mundësi që ta
18 kalonim, megjithëse ishin shumë bashkëpunues, po u pajtuan që
19 të mund ta lejonin gazetarin që të merrte sekuenca filmike.

20 Por unë doja të shtoja që Ben Brown, që ishte gazetari
21 dhe unë po i tregoja personave që ishin te pika e kontrollit.
22 Kisha edhe një letër nga komandanti Drini dhe pavarësisht që e
23 kisha këtë letrën, letra nuk bëri punë. Ata e dinin kush
24 ishte, pa diskutim, komandant Drini, por ata më thanë që "Ne
25 duhet të pyesim, nuk mund t'ju lejojmë, se kemi nivele më të

1 larta që duhet të pyesim". Pra, nga komandanti Drini ne kishim
2 marrë këtë letër në mënyrë që të kishim qasje e bashkëpunim
3 nga UÇK-ja, por në rastin në fjalë që sapo ju përmenda, kjo
4 letër nuk hyri në punë, nuk bëri punë.

5 PY. Në atë kontekst, çfarë donte që të filmonte gazetari, një
6 takim negocimi, domethënë për këtë ngjarje po shkonit ju?

7 Bospj që e keni përmendur këtu edhe enë deklaratën e
8 dëshmitarit në mos gabohem. Domethënë, bëhej fjalë për një
9 ngjarje që përfshinte negociata të nivelit të lartë ndërmjet
10 figurave të UÇK-së dhe të tjerëve. Për këtë e keni fjalën?

11 PË. Jo, ka një ngatërrësë këtu. unë pata një bisedë pasuese
12 me një tjetër oficer britanik dhe e kam përmendur këtë. Dhe ai
13 më thotë: "Oh, mund të jetë kështu, sepse edhe ne kemi bërë
14 një takim atë ditë".

15 PY. "Ne" kush ishte -- kush ishin "ne"?

16 PË. "Ne" e kishte fjalën për MVK-në ose mbase për KDOM-in
17 britanik të një niveli më të lartë. Domethënë, u bë kjo lloj
18 lidhjeje dhe mbase kjo mund të ketë qenë arsyeja pse ne nuk u
19 lejuam që të kalonim në atë pikë kontrolli se në raste të
20 tilla kemi pasur mundësi që ta kalojmë atë pikë kontrolli. Por
21 sa i takon gazetarin, gazetari thjeshtë donte të merrte, të
22 bënte regjistrim, të merrte ca pamje. Ne shpresonin që
23 intervista do të bëhej e mundur por nuk ja arritëm dot.
24 Megjithatë, nuk ishte asgjë specifike për UÇK-në.

25 PY. Të jemi të qartë, gjatë interpretimit të fakteve se pse

1 nuk u lejua që të kalonte atë pikë kontrolli atë ditë, besoj
2 që është arsye e vlefshme që ju nuk jeni lejuar sepse po
3 ndodhte një takim i nivelit të lartë midis MVK-së, KDOM-it dhe
4 e nivelit të lartë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kështu
5 që është besoj e kuptueshme edhe për juve që në ndonjëherë një
6 situatë të tillë, domethënë është absolutisht e rëndësishme që
7 njerëzit që nuk njiheshin të mos lejoheshin që të kalojnë
8 sepse takimi ishte i një rëndësie shumë të madhe. Është e
9 shpjegueshme apo jo?

10 PË. Po mund të jetë shpjeguese, megjithatë mund të jetë
11 tërësisht koincidencë. Rastësi pa lidhje fare, që oficeri me
12 të cilin folëm më dha këtë shpjegimin dhe bëri këtë lidhje.
13 Megjithatë, siç e thashë edhe më përpara në raste të tjera kur
14 kemi ndjekur të njëjtën rrugë, mua më është lejuar që të kaloj
15 pikën e kontrollit.

16 PY. Ekzaktësisht. Domethënë, mund të kesh të drejtë, mund të
17 mos kesh të drejtë. Mund të ketë qenë ashtu ose jo.

18 Megjithatë, siç thoni ju, keni pasur mundësi që të kaloni në
19 atë pikë herë të tjera.

20 Dhe sigurisht edhe kolegu juaj kishte të drejtë në atë
21 çfarë ju tha, në kuptimin që ua shpjegoi çfarë po ndodhte.
22 Çfarë ngjarje kishte ndodhur për takimin.

23 PË. Po.

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] Tani do të kalojmë te faqja 54.

25 Besoj jemi nga fundi i pyetjeve. Ju kërkohet ndjesë, e thashë

1 gabim. Jemi në faqen -- në paragrafin 16, faqe 54, nga fundi.
2 PY. Pra, pas shqyrtimit hipotetikusht, në qoftë se do të
3 shohim paragrafin 16, dhe dua që të më thoni në qoftë se
4 vlerësimi i David Wilson, i oficerit ndërlihdës, është një
5 vlerësim me të cilin ju pajtoheni ose jo. Në paragrafin 16
6 thuhet:

7 "Megjithatë, ka pak prova që UÇK-ja po përmirëson në
8 mënyrë domethënëse aftësinë e saj për t'u përballur me forcat
9 jugosllave ose për të ndryshuar qasjen e tyre nën dritën e
10 mësimëve të nxjerra gjatë këtij viti. Duket sikur ata kanë një
11 strukturë komanduese kaotike. Ndërkohë që ka një element
12 ushtarësh ish-profesionistë, shumë prej tyre nuk kanë fare
13 historik dhe trajnim ushtarak. "Organizimi" i tyre duket sikur
14 funksionon në tre ndonjëherë nivele."

15 Si e kuptoni ju këtë përdorimin e thonjzave tek
16 "organizata", te "organizimi". Domethënë, e kuptoni sikur nuk
17 ishin të organizuar, prandaj quhej "organizim" me thonjza? Si
18 mund të na e shpjegoni këtë?

19 PË. Jo të organizuar sipas standardeve tona, ose të paktën
20 standardeve të Kosovës së sotme.

21 PY. Po, pra, domethënë ka një lloj ironie në organizimin që i
22 referohet UÇK-së, prandaj e përdorin në thonjza
23 "organizimin", apo jo?

24 PË. Po, pajtohem me ju.

25 PY. Thuhet që "Organizimi" duket sikur funksionon në tre

1 nivele. Në mënyrë të paqartë ata kanë zona që mbivendosen,
2 zona operimi që mbivendose. Kanë mospëlqime sa i takon
3 urdhrave dhe kanë mosmarrëveshje lidhur me personin, me kush
4 është -- kush ka autoritet", dhe për këtë arsye besoj që
5 pajtoheni me mua që për këtë bëhej falë, domethënë kush e ka
6 kompetencën mbi dikë tjetër, apo jo?

7 PË. Po.

8 PY. "Ndërkohë që ky kokteji është shumë i paqartë për një
9 mëndje ushtarake perëndimore, nuk ka prova që qëllimi kryesor,
10 ose qëllimi që pse janë kaotikë, domethënë, që për të krijuar
11 konfuzion, ose paqartësi".

12 Ky është konstatimi i kolegut tuaj. Si mendoni ju, çfarë
13 mendoni ju?

14 PË. Nuk ishin tërësisht kaotikë.

15 PY. E kuptoj, nuk po ju them që të thoni ju a janë apo jo
16 kaotikë, po këtë thotë kolegu. Megjithatë, do ta them
17 ekzaktësisht siç thuhet këtu në raport. Raporti thotë që
18 natyra konfuzuese, ngatërruese e këtij kokteji është
19 konfuzuese, të ngatërron kur e shikon nga perspektiva e një
20 personi ushtarak perëndimor. Megjithatë, nuk ka provë, nuk ka
21 dëshmi që ata qëllimisht mundohen që ta pasqyrojnë situatën si
22 konfuzuese. Por janë së të tillë.

23 ZNJ. MAYER: [Përkthim] E kundërshtoj mënyrën sesi
24 formulohet kjo.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Fjalët flasin

1 për veten e vet, pra kështu që vazhdoni.

2 Z. EMMERSON: [Përkthim] Shumë mirë. Vazhdojmë më tej.

3 PY. Vazhdon dhe të thuhet për tre lloje të ndryshme të
4 luftëtarëve të UÇK-së.

5 Së pari, janë "Klanet, ose Njësitë e Mbrojtjes së
6 fshatrave, ose klanet në nivel fshatrash".

7 "Ata janë civilë të zakonshëm shqiptarë dhe bëjnë punën e
8 tyre, por gjithsesi, domethënë, kanë ndasitë e tyre dhe çdo
9 kërkesë për të folur e liderin e tyre, udhëheqësin e tyre do
10 të çonte në një përgjigje të pakuptimtë. Ose ndoshta nuk të
11 jep fare asnjë udhëzim. Pra, janë të pa organizuar dhe
12 shpeshherë janë individë dhe zona e tyre e interesit shtrihet
13 përtej kufijve të vijave të tyre. Këta individë janë të
14 pavarur dhe nuk e kanë shumë nivel -- nuk e kanë shumë idenë e
15 nivelit të përgjithshëm. Kështu që këta individë mund të kenë
16 ndikim mbi nivelin e organizimit të UÇK-së, duke marrë
17 parasysh historikun e tyre dhe duke pasur parasysh, le të
18 themi, formimin e tyre."

19 Atëherë, pasi i hodhët një sy këtij paragrafi, a është e
20 qartë që përgjithësisht organizimi ishte në nivel fshati,
21 domethënë thjeshtë ishin një grup njerëzish të fshatit që
22 ishin mbledhur me njëri tjetrin për të mbrojtur ato zonat e
23 tyre lokale? A pajtoheni me këtë kategori?

24 PË. Po, unë e kuptoj referencën që i bën z. Wilson historisë,
25 dhe fakti që këta njerëz po bënë atë çka kishin bërë

1 gjithmonë, edhe më përpara. Megjithatë, në sytë e mi, për mua
2 ata ishin anëtarë të UÇK-së. Për mua kjo ishte e qartë. Ata e
3 kishin mundësinë që të mobilizoheshin në qoftë se do të kishte
4 kërcënim. Kishte njerëz që do të ishin në pozicione të
5 përhershme të caktuara, pra pa diskutim, megjithatë, ashtu siç
6 e kam përshkruar edhe në raportin tim, si në rastin e betejës
7 në Randubravë, e kam vënë re edhe në një tjetër fshat aftësinë
8 për t'u mobilizuar shumë shpejtë. Përgjithësisht djemtë, të
9 rinj, të pa trembur, të përgatitur pa diskutim për të mbrojtur
10 njerëzit e vet, popullin e vet, dhe ata nuk ishin mobilizuar
11 në mënyrë që të mbrohej fshati, por kur doli e nevojshme,
12 ishin të gatshëm dhe u mobilizuan shumë shpejt. Pra,
13 megjithatë këta njerëz, pavarësisht që nuk pritej që të
14 ndodhte sulmi, ishin persona me uniforma, ishin persona të
15 cilët shumë shpejt u mbledhën me njëri tjetrin dhe krijuan
16 formacione, ishin të gatshëm për të marshuar dhe për t'u bërë
17 pjesë e luftës. Domethënë, nuk është se ishte kaq shumë
18 kaotike. Kishte një lloj niveli organizimi.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson,
20 ka ardhur koha për pushimin e drekës.

21 Z. EMMERSON: [Përkthim] Në qoftë se do më lejoni, për
22 pesë minuta mund të mbaroj, nëse është e mundur.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
24 çaktivizuar].

25 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ose mund ta lemë edhe për pas

1 drekës.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
3 marrim pushimin tani, pastaj pas pushimit të drekës për një
4 orë e gjysmë, mund të ktheheni dhe besoj që do të mbarojmë me
5 pyetjet tuaja -- me pyetjet për ju, dëshmitar. Zonja
6 Sekretare, mund ta nxirrni dëshmitarin nga salla.

7 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
9 pushimi deri në orën 14.30.

10 Z. ELLIS: [Përkthim] Sa për t'ju përditësuar, ka të
11 ngjarë që të mos kem fare pyetje. Gjithsesi do ta mendoj në
12 herë gjatë pushimit të kafes. Për t'ju informuar e kisha këtë.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
14 çaktivizuar]

15 Faleminderit të gjithëve. Bëjmë pushimin e drekës. Në
16 orën 14.30 do të mblidhemi përsëri.

17 --- Pauza fillon në orën 13.02

18 --- Seanca rifillon në orën 14.30

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

20 Sekretare, mund të sillni dëshmitarin në sallë.

21 [Dëshmitari vijon dëshminë]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Dëshmitar,
23 vazhdoni të jeni i detyruar të thoni të vërtetën. Z. Emmerson
24 ka dhe sisa pyetje për juve.

25 Z. Emmerson, fjalën e keni ju.

1 Z. EMMERSON: [Përkthim]

2 PY. E shikoni ekranin aty? Shohim kategorinë e parë që kolegu
3 jua j ka identifikuar dhe përshkrimi i tij i njësive vendore në
4 fshatra. Fjalja e fundit:

5 "Me fjalë shumë të thjeshta, këto njësi të UÇK-së mund të
6 krahasohen me njësitë e njësive të mbrojtjes së brendshme".

7 Këto njësi, pra, keni përmendur më herët që këto ishin të
8 bazuara në fshatra në njësi për mbrojtjen mund të
9 dislokoreshin të paktën në zonën për të cilën kishin
10 përgjegjësi. Kur keni biseduar me njerëzit, a zbuluat që këto
11 zakonisht lindnin nga ajo që quhej përpara konfliktit për vite
12 me radhë gjatë atyre ditëve, mbrojtja e fshatit?

13 Pra, struktura në Kosovë mes komunitetit shqiptar ishte
14 që të kishin, që kishin pasur për një kohë të gjatë disa
15 njerëz në fshat që kishin përgjegjësinë për të mbrojtur vendin
16 dhe për të monitoruar. Kishit dijeni për këtë?

17 PË. Jo nuk kam parë këtë zhvillim përpara arritjes time atje,
18 përpara se të shkoja atje. Askush nga vendorët nuk më ka
19 thënë, për shembull, që kishin qenë mbrojtës të fshatit për
20 vite me radhë.

21 Ata, disa prej njerëzve që kam takuar ishin bashkuar së
22 fundmi, mund të jetë ashtu siç thoni ju, por unë nuk jam në
23 gjendje ta konfirmoj.

24 PY. E kuptoj. Pastaj pjesa e dytë është kategoria zyrtare
25 këto për të cilët po flasim. Milicët e zonave vendore:

1 "Janë mbetje të UÇK-së që të cilat ishin të përfshira
2 shumë në ofensivën e verës. Përbënin thelbin, zemrën e UÇK-së
3 më para, tani kanë rol dytësor. Ndonjëherë, kjo shihej qartë,
4 se komandantët e tyre ishin të pakënaqur. Por këto njësi në
5 mënyrë të thjeshtë mund të identifikoheshin me njësi
6 territoriale".

7 Ju keni qenë vetë në njësi territoriale të Mbretërisë së
8 Bashkuar. Dhe e kuptoni këtë krahasim apo jo? Pra, është diçka
9 që këto ishin nivele të mbrojtjes mbi nivelin e fshatit dhe
10 ishin të organizuar sipas zonave?

11 PË. Po pranoj këtë analizë. Nuk mund të them që duhet ta
12 klasifikoj në këtë mënyrë. Besoj, mendoj që është një
13 përshkrim i arsyeshëm. Kam takuar njerëz të cilët e dija që
14 kishin qenë të përfshirë në ngjarjet e verës së 1998, por që
15 nuk ishin në asnjë mënyrë profesionistë. Ndoshta ishin më të
16 vjetër dhe mund të ishin luftëtarë të vendosur por jo të aftë
17 për zhvillime të mëtejshme apo në njësi tokësore aktive.

18 PY. Është ndoshta e qartë nëse kur thuhet zonat vendore nëse
19 i referohet zonave, nuk është e qartë këtu. Por a mund t'ju
20 pyes: Keni ju dijeni që zona e Pashtrikut nuk ka ekzistuar si
21 e tillë deri pothuajse në momentin kur keni shkuar ju atje?
22 Duke ditur që zonat janë krijuar në momente të ndryshme
23 kohore.

24 PË. Po.

25 PY. Domethënë, keni patur dijeni?

1 PË. Po, është e saktë. Nuk është përmendur asnjëherë zona e
2 Pashtrikut në këtë nivel komande në shpjegimin që më është
3 dhënë mu për ngjarjet gjatë verës.

4 PY. Saktësisht dhe, për rrjedhojë, Drini është emëruar apo
5 zgjedhur, nuk po e bëj këtë dallim, por është bërë komandant i
6 zonës së Pashtrikut rreth kohës kur ju jeni vendos aty
7 dislokuar si MVK?

8 PË. Po.

9 PY. Pastaj keni kategorinë që:

10 "Njësitë në thelb, këto janë personat më të rëndësishëm
11 që po bëhen gjithmonë e më të rëndësishëm në UÇK dhe është
12 irrituese shumë që të jemi të detyruar të pranojmë që nuk dimë
13 pothuajse asnjë gjë për aktivitetin e tyre. Ajo që ndjek në
14 këtë nënparagraf është thjeshtë, që vazhdon më tej, këtu është
15 thjesht spekulim. Komanda më e lartë është pothuajse
16 kolektive".

17 "Shumë prej komandantëve operacionalë janë ish-
18 profesionistë, ushtarakë profesionistë, kryesisht nga ushtria
19 jugosllave ... dhe kanë bërë përpjekje të rëndësishme".

20 Në qoftë se mund të shohim poshtëshënimin, për t'u
21 paraqitur si forcë jopolitike.

22 Tani në qoftë se mund të shohim poshtëshënimin që është
23 në faqen 566, faqja 14 në fund. Pjesa sipërme në të majtë në
24 faqen 60, nëse mund ta në paraqisni këtë.

25 Pra, në qoftë se shohim poshtëshënimin 11. Është shënimi

1 i fjalisë që sapo lexuam ku:

2 "Komanda e lartë, më e lartë është kolektive".

3 Ndërsa këtu thuhet:

4 "Ndërkohë që udhëheqja kolektive mund të krijojë
5 iluzionin e një harmonie dhe qëllimi të përbashkët ka më shumë
6 gjasë që është më shumë e lidhur me urrejtjen që kanë
7 shqiptarët ndaj nënshtrimit apo vartësisë hierarkike".

8 A e keni përjetuar edhe ju të njëjtën përvojë? Apo është
9 përshtypja juaj që keni krijuar brenda UÇK-së?

10 PË. Besoj që është në përputhje me disa prej konstatimeve që
11 kam bërë, përvojën që kam patur me shqiptarët në përgjithësi,
12 ndoshta pastaj ndikuar dhe nga shërbimi im me Trupat Mbrojtëse
13 të Kosovës më vonë, njerëzit kishin tendencë t'i referoheshin
14 njëri-tjetrit si individ, si personalitete individuale më
15 shumë sesa komandanti ky, komandanti ai, ky apo ai.

16 Pra, ishte ndryshe nga ajo që mund të prisnim ne për
17 forcat e armatosura tonat për shembull. Është ndryshe si
18 analizë, po përputhet me atë që kam konstatuar dhe unë.

19 PY. A mund të kalojmë shkurtimisht në seancë private, ju
20 lutem.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

22 Sekretare, na kaloni në seancë private për të mbrojtur
23 dëshmitarin.

24 [Seancë private]

25 [Seancë private teksti i fshirë]

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3 [Seancë e hapur]

4 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

5 Z. EMMERSON: [Përkthim]

6 PY. Ushtarët e lartë profesionistë që punonin të dërguar nga
7 shtetet e tyre që punonin në MVK edhe kanë patur nga përvoja e
8 tyre e kaluar dhe njohuri të thella të rregullave të
9 konfliktit të armatosur?

10 PË. Po. Për këtë ata janë ushtarakë profesionistë.

11 PY. Kjo do të bëja dhe unë. A ishte diçka për të cilën ju
12 jeni trajnuar apo keni rekrutuar sepse e njihnit, i kishit
13 këto aftësi?

14 PË. Unë isha i trajnuar sepse zyra e Ministrisë së Punëve të
15 Jashtme të Komonuelthit të Mbretërisë së Bashkuar në
16 rekrutimin e stafit për MVK-në kërkonte persona të cilët ose
17 ishin përvojë shërbimi në rezerve, ose ishin duke shërbyer apo
18 që ishin zyrtarë oficerë relativisht të lartë që kishin
19 shërbyer në forcat ushtarake, gradë të ngjashme apo më të
20 lartë. Pra, të gjithë ishin të trajnuar për sa u përket
21 ligjeve në konflikte të armatosura. Nuk jam i sigurt se çfarë
22 hollësish na janë dhënë në trajnimin apo përgatitjen që kemi
23 bërë përpara dislokimit por ka qenë pjesë kryesore e
24 kontekstit.

25 PY. A do të thotë kjo që në kuadër të punës tuaj ishin diçka

1 që duhej të dinit sepse po kërkonit të konstatonit shkelje të
2 mundshme të armëpushimit apo shkeljet eventuale të ligjit
3 humanitar?

4 PË. Po, saktë.

5 PY. Faleminderit. Ndoshta me kontekstin marr me mend, nuk
6 është test. E kuptoni kur bëhet fjalë për civilë që marrin
7 pjesë në luftë të drejtpërdrejtë në përplasje në konflikt, e
8 kuptoni këtë?

9 PË. Po, e kuptoj. Dhe kjo pa hyrë në debate se kur është
10 civil që merr pjesë në përplasjet në mënyrë të drejtpërdrejtë
11 është pika kryesore është kur një civil bëhet luftëtar në
12 momentin që merr armë dhe lufton forcat armike, a është saktë?

13 PË. Po.

14 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kundërshtim. Besoj që po kalojmë
15 tani në mendime -- kërkimin e mendimeve ligjore, opinioneve
16 ligjore për çështje të caktuara.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po. E pranoj
18 këtë.

19 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk po kërkoj që dëshmitari të
20 japë mendimet e tij ligjore

21 PY. A jeni trajnuar si pjesë e misionit të MVK-së, më duket
22 që jeni përgjigjur po, ndërkohë që po i bëj kundërshtimin po
23 thashë të kthehemi që sigurohemi që futet në procesverbal. A
24 jeni i trajnuar për t'u siguruar që në disa rrethana që një
25 civil që merrte armë mund të konsiderohej në mënyrë legjitime

1 si shënjestër legjitime sepse kishte marrë armët dhe

2 konsiderohej si luftëtar?

3 PË. Kjo ka qenë pjesë sigurisht e njohurisë së gjerë që kam

4 ditur. Nuk mund ta them që jam trajnuar në mënyrë specifike

5 konkrete për këtë, por në kuadër të misionit të MVK-së po kam

6 qenë vetë i informuar për këtë dhe i dija këto gjëra.

7 Ndoshta mund të shtoj që nuk më kujtohet. Ja vlen të

8 përmendet dhe të themi që UÇK-ja në ato raste kur unë kam

9 vëzhguar UÇK-në në situata luftimi në të gjitha këto raste ata

10 kishin uniforma që ishin qartësisht të identifikueshme. Kjo

11 ishte e padyshimtë. Ata ishin padyshim pjesë e një force të

12 armatosur dhe deklaroheshin si të tillë.

13 PY. Ka prova të tjera për sa i përket uniformës dhe

14 uniformave dhe gjërave të tilla, por, siç u bë dhe

15 kundërshtimi, ju lutem mos shprehni mendime tuaja sa i përket

16 situatës.

17 Po a kam të drejtë të them që trajnimi juaj ka përfshirë

18 informimin tuaj, njohuritë praktike, kur bëhej fjalë për

19 ngjarje që duhet të raportoheshin si shkelje të ligjit

20 ndërkombëtar që për rrjedhojë pjesë e misionit tuaj ka qenë të

21 kuptoni të bëni dallimin mes një civili që merr pjesë në

22 mënyrë të drejtpërdrejtë në luftë, në përplasje dhe një

23 ushtari të rekrutuar të renditur, pra, në këto raste një civil

24 mund të shënjestrohet vetë në çdo rrethanë, kurse civili vetëm

25 në momentet kur ka armë dhe merr pjesë, pra, ndërsa ushtarët

1 mund të sulmohen dhe kur janë në kazerma duke fjetur?

2 PË. Po.

3 PY. Sa i përket konfliktit, ligjit të konfliktit të
4 armatosur po dhe i kemi biseduar që ishin dhe marrëdhëniet të
5 cilat ishin arritur në atë moment.

6 PË. Saktësisht.

7 PY. Por ne po flasim për ligjet e luftës - bëhet fjalë për
8 persona që nuk janë në gjendje të marrin pjesë sepse janë të
9 sëmurë apo në spital, përndryshe mund të sulmohet çdo ushtar i
10 uniformuar që është pjesë e forcave të armatosura në çdo kohë?

11 PË. Po, në qoftë se jemi në gjendje konflikti.

12 PY. Dhe ju po punonit mbi këtë bazë sepse ishte një gjendje
13 konflikti apo jo?

14 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kundërshtim. Edhe këtu bëhet fjalë
15 për mendime ligjore dhe nuk mendoj që dëshmitari është i
16 kualifikuar që të përgjigjet këtyre pyetjeve.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kjo pranohet.
18 Kundërshtimi pranohet. Dhe ju thatë që ju duheshin dhe pesë
19 minuta, kaluam 20 minuta dhe po flasim për ligje të cilat mund
20 t'i verifikojmë vetë, s'kemi nevojë për ato.

21 Z. EMMERSON: [Përkthim] E kuptoj, po është e lidhur me
22 kontekstin për të cilat ky dëshmitar ka njohuri.

23 PY. Sepse një prej incidenteve që keni hetuar ju kishte të
24 bënte, lidhej me rrëmbimin e z. Xhafiqi. Dua të verifikoj dy
25 tre gjëra me juve, disa gjëra me juve.

1 Së pari, në hetimin që keni bërë keni vërtetuar që ai
2 ishte oficer i MUP-it, i regjistruar, apo jo?

3 PË. Ishte oficer i regjistruar në mënyrë të rregullt që
4 punonte në atë ministri. Me sa e kam kuptuar unë, roli i tij
5 që nga fillimi ishte që të merrej me dokumente.

6 PY. Po, por siç e dini si pjesëtar i forcave të armatosura i
7 regjistruar në mënyrë të duhur dhe i uniformuar nuk ka rëndësi
8 a jeni kuzhinier apo merreni me trafikun?

9 PË. Unë nuk e di as njërin as tjetrën. Nuk e a ka patur
10 uniformë po apo jo në kohën kur është ndaluar.

11 PY. A do të pranoni që në këtë hetim nuk po flasim për
12 shenjëstrimin e dikujt, po flasim për ndalimin dhe arrestimin
13 dhe mbajtjen në ndalim të dikujt. A pranoi që duke qenë që në
14 atë kohë kishte një operacione ushtarake të MUP-it që
15 zhvilloheshin do të ishte legjitime që të ndalohej një person
16 që ishte pjesëtar i këtij MUP-i?

17 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kundërshtojmë, përfundimin ose ky
18 veprim ishte legjitim apo jo.

19 Z. EMMERSON: [Përkthim] Tani ky dëshmitar ka hetuar këtë
20 çështje. Kjo nuk është çështja përfundimtare e thelbit është
21 s'ka absolutisht asnjë arsye që të mos shpjegojë qasjen që ai
22 ka patur në këtë.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përveç faktit
24 që kjo është komplet, s'ka asnjë rëndësi, po vazhdoni më tej.

25 Z. EMMERSON: [Përkthim] Mirë. E kam fjalën dëshmitari

1 është në gjendje që të na ndrit -- të na informojë neve në
2 qoftë se ky ishte një ndalim arbitrar apo jo, këtu në këtë
3 aspekt është relevant?

4 DËSHMITARI: [Përkthim] Përsërisni pyetjen, z. Gjyqtar?

5 Z. EMMERSON: [Përkthim]

6 PY. Pyetja ishte që: A është e saktë që në atë kohë po
7 zhvilloheshin operacione ushtarake të MUP-it në Kosovë dhe
8 afër kufirit dhe menjëherë në afërsi të zonës ku ju keni bërë
9 hetimin përpara dhe pas në këtë zonë ku forcat e MUP-it po
10 përdornin fuqi dhe për të sulmuar UÇK-në?

11 PË. Më duket pyetja e vështirë. Bëhet fjalë për një person që
12 shkonte në punë.

13 PY. Nuk po flasim për pjesën morale të historisë. Por
14 operacionet e MUP-it edhe në fakt edhe ata në një farë mënyre
15 po shkonin në punë kur bënë luftime. Po bëhet fjalë që kemi
16 MUP-in që luftonin kundër UÇK-së përpara dhe menjëherë pas
17 kësaj ngjarjeje?

18 PË. Për cilat operacione e keni fjalën saktësisht?

19 PY. Ndoshta mund të shohim deklaratën tuaj.

20 PË. Ndoshta po flasim për betejën e Randubravës?

21 PY. Fillon me deklaratën tuaj që është P392, paragrafi 92.
22 Këtu bëhet fjalë për 9 marsin, pra, e gjitha kjo pjesë. Ishte
23 më 9, apo jo, që keni bërë këtë hetim?

24 PË. Po.

25 PY. Pra, janë përpjekje të ndryshme që vazhdonin në këtë

1 periudhë kohore në përpjekje për të gjetur z. Xhafiqi.
2 Ndërkohë që unë personalisht isha shumë i shqetësuar për
3 mirëqenien dhe sigurinë e tij në ditët në vijim jam përfshirë
4 personalisht për t'u përgjigjur ngjarjeve të tjera që ndodhën
5 në terren, ndërsa ndërlihdja CC1 me RC1 me këto po merrej
6 kryesisht drejtori i CC1, z. Bordet".

7 Pastaj vazhdon:

8 "Për shembull, në mëngjesin e datës 10 mars 1999", bëhet
9 fjalë për ditën në vijim "... pas takimit tonë në orët e vona
10 të natës në Tërpezë, unë u dislokova dhe shkova tek një
11 incident ku një M-80 transportues i blinduar personel i MUP-it
12 qëllonte nga afërsia e 'Hotel Kaliforni' afër rrugës Malishevë
13 -Llapushnik ishte zjarr në mënyrë të përsëritur automatik në
14 drejtim të pozicionit të UÇK-së dhe një pjesë e ndarë e
15 fshatit të Tërpezës ku kam parë disa goditje të shtëpive.
16 Besoj që ky incident kishte filluar nga MUP-i, arma ku është
17 shkarkuar në mënyrë me neglizhencë dhe nuk ndërlihdhej me
18 takimin tonë me Çelikon në pjesën e sipërme të Tërpezës.
19 Gjatë natës incidenti ka qenë -- u zgjodh në mënyrë të
20 suksesshme nga ne, pa shkaktuar viktima, pra kjo ndodhi në
21 afërsi, shumë afër vendit ku po bënit hetimet?

22 Besoj që të gjithë pajtohemi sepse këtu është një
23 angazhim, një përplasje e armatosur mes dy palëve.

24 PË. Nëse versioni i ngjarjeve i dhënë nga MUP-i është i saktë
25 atëherë pretendimi i tyre për të cilin kisha dyshime ishte se

1 njëri prej personave, ushtarëve të tyre ishte plagosur nga të
2 shtënat që vinin nga pjesa poshtë e ulët e Tërpezës. Në qoftë
3 se kjo është e saktë këta kanë të drejtë në një farë mase që
4 të kthejnë zjarrin.

5 PY. Unë nuk po ju kërkoj që të gjykoni kush kishte të drejtë
6 apo kush kishte gabim në këtë incident. Ajo që përpiqem të
7 them është kanë ndodhur përplasje të armatosura mes MUP-it,
8 luftime dhe MUP-it shumë afër vendit ku ju po hetonit që të
9 nesërmen, kam të drejtë?

10 PË. Nuk ishin luftime. Ajo që pashë unë, është që MUP-i po
11 qëllonte në mënyrë të papërgjegjshme, sipas mendimit tim, në
12 drejtim të fshatit ku kam parë aktivitete të UÇK-së. Edhe pse
13 kemi pasur një patrullë më poshtë aty që mund të kenë
14 informacione më të sakta se ne.

15 PY. Në deklaratën tuaj keni thënë që ata qëlluan në drejtim
16 të pozicioneve të UÇK-së. Është e rëndësishme kjo që po pyetje
17 që po bëj në kontekstin që po flasim --

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni, pra
19 dhe përfundoni.

20 Z. EMMERSON: [Përkthim]

21 PY. Pra, ju thatë që ata po qëllonin në drejtim të
22 pozicioneve të UÇK-së?

23 PË. Sigurisht që ka qenë territor i kontrolluar nga UÇK-ja që
24 ta themi kështu.

25 PY. Dhe pa hyrë në faktin se kush kishte të drejtë dhe kush

1 ishte gabim, pajtoheni që UÇK-ja është përgjegjgur zjarrit dhe
2 kjo bën një përplasje të armatosur apo jo?

3 PË. Unë nuk kam parë prova që UÇK-ja ka qëlluar në drejtim të
4 automjeteve të blinduara. Në kthim nga Malisheva duke zbritur
5 ka patur të shtëna, por nuk ka qenë përplasje e armatosur mes
6 dy palëve, domethënë, kjo pjesa e dytë ka ndodhur pak më vonë.

7 PY. Por ju pranoni që UÇK-ja ka trajtuar MUP-in si rrezik i
8 pranishëm aty?

9 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Kundërshtim. Lidhur me pikëpamjen
10 e UÇK-së apo sesi UÇK-ja shihte MUP-in në atë zonë në atë
11 kohë.

12 Z. EMMERSON: [Përkthim]

13 PY. E pranoni që në fakt MUP-i ishte e rrezikshme e
14 vazhdueshme kundrejt forcave të UÇK-së?

15 PË. Kur gjuajtën me armë nga MUP-i ishte komandanti,
16 komandanti i zonës në automjet dhe po ndiqte automjetin tim
17 për të shkuar drejt Malishevës. Nuk është se ai po shkonte
18 drejt territoreve të UÇK-së. Ai ishte në magjistrale, thjesht
19 po ecte në magjistrale.

20 PY. Kur në momentin nga hoteli MUP-i gjuan me armë në
21 pozicionet e UÇK-së, a nuk mendoni ju se këta ishin një rrezik
22 i pranishëm?

23 ZNJ. MAYER: [Përkthim] E kundërshtoj se është dhënë
24 përgjigje.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

1 DËSHMITARI: [Përkthim] Jo, nuk ishte një rrezik i
2 pranishëm, ishte një rast i izoluar.

3 Z. EMMERSON: [Përkthim
4 PY. Mbase unë s'po e bëj pyetjen e qartë. Nuk po flas për
5 rastin kur UÇK-ja goditi automjetin e MUP-it që po lëvizte. E
6 kam për rastin kur, shpreheni dhe ju në deklaratën tuaj, që
7 MUP-i gjuajti me automatik pozicionet e UÇK-së, pra, gjuajti
8 me armë UÇK-në?

9 PË. Po, absolutisht. Pra, në atë kohë ishte një rrezik i
10 pranishëm.

11 PY. Faleminderit.

12 Z. EMMERSON: [Përkthim] Të shohim provën materiale P408.
13 Shohim paragrafin që fillon me fjalën "Përpyekje".

14 PË. Besoj se ky është raporti juaj nga hetimi që keni bërë?
15 Ky është raporti që keni dorëzuar ju, më saktë, e ka dorëzuar
16 drejtori juaj po është një hetim që keni bërë ju.

17 Dhe këtu shohim një përmbledhje të takimit që keni bërë
18 ju me personin që mendonit se ishte z. Limaj. Thuhet:

19 "Përpyekjet për të bërë një vizitë personale tek polici
20 shqiptar i MUP-it, Xhafiqi, që ishte marrë nga shtëpia e tij e
21 tij në Piranë më 9 mars të 1999 ... ishin të pasuksesshme. U
22 mor konfirmimi në orën 15.00 të pasdites se komanda e lartë e
23 UÇK-së e pranuan se kishin marrë nën kontroll apo nën ruajtje
24 dhe se do të vijonin ta trajtonin në 'Konventën e Gjenevës'
25 dhe synonin ta lironin sa më shpejt se do ta lironin në

1 momentin që operacionet e ushtrisë jugosllave dhe të MUP-it në
2 zonën kufitare do të ndërprisnin".

3 Ju keni ndonjë provë për të thënë që ai ishte trajtuar në
4 kundërshtim me Konventën e Gjenevës? Keni ndonjë provë për
5 këtë, çdo lloj prove?

6 PË. Jo. Mua më kishin garantuar, pra, personi që kishin
7 takuar më garantoj që do të trajtohet në përputhje me
8 konventën e Gjenevës, ndonëse unë kisha shqetësimet e mia.

9 PY. E kuptoj. Ju kishit shqetësimet tuaja, po as në ato
10 momente nuk doli gjë nga pikëpamja e provave dhe as më vonë që
11 të tregonin ty apo të tjerëve që ky mashkull nuk ishte
12 trajtuar në përputhje me Konventën e Gjenevës apo të ishte
13 keqtrajtuar në ndonjë formë?

14 PË. Më thanë që e kishin keqtrajtuar por prova për këtë nuk
15 kam.

16 PY. Kush jua tha këtë?

17 PË. Më pas kur isha në Kosovë, bëra vetë disa interesime,
18 pyetja a ka marrë vesh njeri çfarë ndodhi për këtë rast. Nuk
19 mund të them me siguri nga më erdhi informacioni por mbase kam
20 lexuar ndonjë gjë në Gjykatën e TPNJ-së. Nuk është dëshmia ime
21 kjo është mënyra sesi e kuptoj unë. Një dorë e tretë - më
22 falni - një burim i tretë është që personi në fakt është
23 keqtrajtuar dhe më pas është vrarë.

24 PY. Ju ama nuk mund të na thoni çfarë burimi keni pasur?

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E mbaruat

1 kohën tuaj, z. Emmerson.

2 Z. Ellis?

3 Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk kemi asnjë
4 pyetje.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka pyetje nga
6 Prokuroria?

7 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Po.

8 A mund të shohim sërish dokumentin që përdorte z.

9 Emmerson që ishte me numër prove materiale P403?

10 Pyetje vijuese nga znj. Mayer:

11 ZNJ. MAYER: [Përkthim]

12 PY. Tek i njëjti paragraf, z. Young, ku ju pyetën për vendin
13 ku po mbahej ky mashkull, ju po përgjigjeshit, kur ju pyeti z.
14 Emmerson, se ju kishit shqetësimet tuaj ndonëse ju kishin
15 garantuar që po trajtohej në këtë formë.

16 A mund të vazhdojmë me fjalinë ku thuhet:

17 "Duke pasur parasysh trajtimet e mëparshme të UÇK-së ndaj
18 të burgosurve pasi kishim marrë garanci të njëjta, pra, një i
19 vdekur dhe një i rrahur, nevoja që OSBE-ja ta takonte
20 personalisht të ndaluarin u theksua. Kjo duhet të ndiqet
21 ngushtësisht nga zyrat qendrore të MVK-së".

22 A ishin këto shqetësimet që shprehët ju para një çasti,
23 në lidhje me këtë?

24 PË. Ka të bëjë me ato që ju ndodhi vëllezërve Savelic të
25 cilët nuk besoj se i kemi përmendur.

1 PY. Këtu po pyes për këtë raport nëse ishin shqetësimet e
2 tuaja për mënyrë sesi ishin trajtuar të ndaluarit ndonëse UÇK-
3 ja kishte dhënë garanci se do t'i trajtonte siç duhet?

4 PË. Po, kështu është.

5 PY. Ju bëri pyetje z. Roberts lidhur me përshkrimin që i bëtë
6 takimit afër Randubravës ose në Randubravë, sidomos në
7 deklaratën që keni dhënë më herët, se kush ka qenë i pranishëm
8 dhe ju bëri pyetje lidhur me deklaratën që i keni dhënë TPNJ-
9 së që është me provën materiale P407, dhe ju thatë që përveç
10 gjeneral Maisonneuve dhe komandant Drinit, Georges Bordet
11 ishte atje. Dhe më pas ai bëri një pyetje dhe ju tha po në
12 deklaratën e ZPS-së nuk e keni thënë që dhe z. Bordet ka qenë
13 atje. A ju kujtohet kjo linjë pyetjesh?

14 PË. Po.

15 ZNJ. MAYER: [Përkthim] I lutem Sekretares të nxjerrë në
16 ekran materialin me numër P392 dhe të shihnim paragrafin 63
17 dhe 64, që është në faqen 17 të materialit PDF.

18 PY. Vërej që ju e pranuat kur ju pyeti z. Roberts, ju kërkoj
19 falje nëse s'e kam thënë, po të shohim paragrafin 63 dhe 64
20 kur flitet për këtë takim dhe kur shkuat në Randubravë, në
21 fund të paragrafit 64 thuhet që:

22 "Veç z. Maisonneuve dhe erdhi i shoqëruar nga Drini në
23 Rahovec erdhi dhe z. Bordet".

24 E shihni këtë?

25 PË. Po e shoh. Saktë.

1 PY. Ju bëri disa pyetje z. Roberts lidhur me vendin apo
2 vendndodhjen ku keni parë Dhjetëshin. Ju kujtohet kjo linjë
3 pyetjesh?

4 PË. Po.

5 PY. Në përgjigje të pyetjeve nëse doli referenca e Dhjetëshit
6 në këtë deklaratë, nëse përmendej Dhjetëshi në këtë deklaratë,
7 që bilëe korrigjoj veten kjo nuk është deklaratë është një
8 raport që e kishte shënuar ky oficeri kanadez, është me numrin
9 P406, ju thatë ky nuk është raport i imi. Dhe thatë nuk është
10 deklarata ime, është raporti i dikujt tjetër që po merrte
11 informacione prej jush dhe të tjerëve.

12 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Dua të fokusohemi tani tek prova
13 materiale që është P407 e cila është një deklaratë që e keni
14 përgatitur ju në shtator të 2000 për ish-Tribunalin e Hagës.
15 Doja që të vendosej faqja 3 e këtij raporti në ekran.

16 PY. E shihni në fillim të faqes, z. Young, ku thoni vendin ku
17 jeni takuar me këtë personin që kolegët tuaj e njohën si
18 Dhjetëshi dhe "një përfaqësues i lartë i Dhjetës" thuhet në
19 deklaratë?

20 PË. Po.

21 PY. Në cilin vend thatë ju që jeni takuar?

22 PË. Besoj, tani pasi po e mendoj këtë pyetje, nuk mund të
23 them me siguri se ku është përmendur Dhjeta. Por unë e di me
24 siguri që Dhjeta është përmendur. Sa i takon zotërisë që
25 kishte veshur rroba civile dhe syze, personi që takuam ne në

1 Reti, kishte syze, po ishte një person tjetër që mbante syze
2 në Tërpezë, ishte tjetër njeri që dukej në fakt ishte një
3 zotni shumë i civilizuar dhe më dha përshtypjen se ishte një
4 person që merrej me ndërkombëtarët. Nuk më kujtohet që të
5 fliste anglisht po m'u duk si një njeri që kishte shumë besim
6 tek vetja. Mund të ishte një civil pjesë e udhëheqjes civile.
7 PY. E vlerësoj. Është e drejtë të themi që kur ke parë këto
8 dokumente këto javë si deklarata juaj e TPNJ-së dhe deklarata
9 juaj e ZPS-së përmendin rrëfimin apo historikun për rrëmbimin
10 e Xhafiqit dhe përfshirjen tuaj nga pikëpamja kronologjike dhe
11 ju flisni çfarë ndodhi në një takim dhe çfarë ndodhi në
12 takimin tjetër në terma të përgjithshëm?

13 PË. Po.

14 PY. Ju kujtohen pyetjet që ju bëri z. Roberts për takimin e
15 dytë në Tërpezë, ku përshkruani, që e përshkruani si në
16 deklaratën tuaj që ka numrin P392 dhe në P407 dhe po këtu në
17 sallën e gjyqit këto dy ditë e keni përmendur dhe keni folur
18 për takimin e dytë që keni pasur në Tërpezë me personin që ju
19 besonit që ishte Fatmir Limaj i njohur ndryshe si Çeliku. Ju
20 bënë pyetje ku e bazoni ju këtë njohuri që Fatmir Limaj,
21 Çeliku, ishte personi që takuat ju. Ju kujtohen këto pyetje?

22 PË. Po.

23 PY. Në përgjigjet tuaja dua të përmend disa nga përgjigjet
24 tuaja sepse ishin shumë të shpërndara. Ju bënë një pyetje ju
25 thanë një pyetje që baza ishte vetëm që ua kanë thënë kolegët

1 që ishte ai person, por besoj se ju thatë që ju e njohët këtë
2 person si nga kolegët dhe nga opinionet apo çfarë ju thanë
3 përkthyesit që kishin shumë përvojë sepse e kishin takuar me
4 persona të tjerë, kështu?

5 PË. Kështu.

6 PY. Dhe po ashtu ishte bazuar në faktin që kishit parë
7 fotografi të Fatmir Limaj dhe të personit që nuk duam ta
8 identifikojmë, por ju thatë ajo që kishit parë ju në fotografi
9 i përkonte personit që po takonit ju në takimin ballë
10 përballë, pra, fotografia dhe peroni ballë përballë dukej se
11 ishin i njëjti.

12 PË. Po.

13 PY. Po ashtu përmendët më herët, po në pyetjet që u bëri z.
14 Roberts, që veprimet e tij personi përballë jush përputhet me
15 përshkrimin që kishit marrë për të. Nuk dua të flasim për
16 gjëra që janë trajtuar po të flasim pak, kur thoni veprimet e
17 keni fjalën e keni fjalën për paraqitjen e këtij personi apo
18 mënyrën si qëndronte ky person, mund të na e shpjegoni çfarë
19 keni dashe të thoni me këtë?

20 PË. "Paraqitje" mbase është fjala më e përshtatshme. Oficeri
21 i UÇK-së që takuam ne, po sillej në një mënyrë disi specifike
22 pak kokëfortë, nuk ishte bashkëpunues, nuk u përgjigjej
23 kërkesave tona, nuk u reagonte mirë ndaj mendimeve tona dhe
24 zakonisht UÇK-ja nuk vepronte kështu, përpigjej të
25 bashkëpunonte të gjenim një marrëveshje të na garantonte

1 ndonjë mënyrë. Qëndrimi i këtij personi nuk ishte i tillë.

2 Edhe ai madje na pyeti drejtpërdrejt në qoftë se kishim
3 kompetenca për të trajtuar këtë çështje.

4 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Dua të shohim materialin P392,
5 faqja 22, paragrafi 83.

6 PY. Lexojeni vetë paragrafin nuk po ua lexoj unë dhe pastaj
7 po bëj pyetjet.

8 PË. Po.

9 PY. Pra, këtu përshkruani dhe thoni se keni biseduar me një
10 person që ju e njihnit si Fatmir Limaj, Çeliku dhe po
11 përpiqeshit të komunikoni me të, të shihnit kushtet gjendjen
12 e të ndaluarit ta shihnit me sytë tuaj, apo jo?

13 PË. Po.

14 PY. Dhe më pas në deklaratë që është në fakt tashmë e pranuar
15 si provë, z. Limaj e kundërshtonte dhe, mënyra si u shprehët
16 dhe ju, ai po ju thoshte MVK-ja nuk është fare e nevojshme,
17 s'ka fare të drejtë apo kompetencë të bëj, nuk ka kompetencë
18 më saktë të bëjë kërkesa të tilla?

19 PË. E saktë.

20 PY. Këtu thuhet në deklaratën tuaj se ai po ju thoshte se kjo
21 ishte një çështje që mund ta trajtonte Kryqi i Kuq. Me sa
22 kuptuat ju, e kishe fjalën për Komunitetin Ndërkombëtar të
23 Kryqit të Kuq?

24 PË. Po.

25 PY. Dhe kjo edhe subjekti që përmendet në Konventën e

1 Gjenevës si subjekti i parë që ka kompetencë për të verifikuar
2 statusin e të ndaluarve, gjendjen e të ndaluarve?

3 PË. Po.

4 PY. Nga përvoja që keni pasur ju në Kosovë dhe me MVK-në a
5 ishte e nevojshme që ju të kishit biseda me persona të vendit,
6 të zonës apo ushtarë të nivelit të ulët për të kuptuar kush
7 kishte qasje te të burgosurit apo kush ishte autoriteti sipas
8 Konventës së Gjenevës?

9 PË. Jo në këto rrethana tamam. Më kujtohet që i këshillonin
10 personat e zonës që na kontaktonin për personat që ishin
11 zhdukur. E kam fjalën për personat që ishin zhdukur që kur
12 kishte filluar ofensiva, jo vetëm në periudhën që shkuam ne.
13 Më kujtohet që i këshilloja të kontaktonin Kryqin e Kuq
14 Ndërkombëtar, ndonjëherë dhe ne i ndihmonim. Mbaj mend që kemi
15 pasur një sektor në zyrat tona qendrore rajonale për personat
16 e zhdukur dhe që ky sektor bënte dhe komunikimin me Kryqin e
17 Kuq.

18 PY. E kuptoj. Po nuk ishte kjo tamam pyetja ime. E kuptoj që
19 ju jepnit këshilla kur kërkonin një të afërm që ishte zhdukur,
20 ju i referonit te OJQ apo te subjekti përgjegjës, siç është
21 dhe Kryqi i Kuq, por po them për dikë që përfaqësonte ata për
22 llogari të organizatës ushtarake dhe ky u shpjegon ju që nuk
23 keni status dhe ju jeni organizatë tjetër dhe ju nuk jeni të
24 autorizuar nga Konventa e Gjenevës t'i trajtoni këto raste të
25 tilla. Pyetja ime është sa herë ndodhnin biseda të tilla?

1 PË. Nuk më kujtohet ndonjë bisedë tjetër e tillë. Sigurisht
2 jo në mënyrën sesi u bë nga personi me të cilin kishim
3 përballë kjo bisedë.

4 PY. Duke qenë se kjo nuk është diçka e zakonshme, a mund ta
5 shpjegoni këtë person si një person që e njihte shumë mirë
6 ligjin apo përgjegjësitë ushtarake, kishte një njohuri më të
7 hollësishme?

8 Z. ELLIS: [Përkthim] Përpara se të bëjë përgjigje a mund
9 të kundërshtoj pak mënyrën sugjestionuese si po bën pyetjet
10 Prokurorja, pyetjet shitesë nuk kanë për synim që të bëhen
11 pyetje sugjestionuese?

12 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Mirë, do jem pak më e kujdesshme
13 po përpiqesha që t'i bëja sa më shpejt, po do jem më e
14 kujdesshme. Besoj se pyetja e fundit nuk ishte sugjestionuese
15 megjithatë po jua rilexoj dhe njëherë.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Mbështesim kundërshtimin.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë unë
18 do ju lutesha që mos e lexoni më pyetjen.

19 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Do e lexoj vetë unë tani, në
20 mënyrë që ta riformuloj dhe mos ta bëj pyetjen në mënyrë
21 sugjestionuese për të njëjtën temë.

22 PY. Si do ta përshkruanit shkallën e njohurisë që kishte
23 personi, që ju e identifikoni si Fatmir Limaj, lidhur me këtë
24 temë kur po bisedonte me ju për Konventën e Gjenevës dhe rolin
25 e Kryqit të Kuq përkundrejt rolit të MVK-së, sa njohuri

1 kishte?

2 PË. Nuk u citua asnjë gjë nga Konventa, po zotnia, sikurse
3 dhe në deklaratën time një mënyrë pak me tërë vetëbesim dhe
4 pak ton të papërshtatshëm dhe ishte shumë i qartë edhe ishte i
5 gatshëm të diskutonte më tej. Ai ne këtë na e tha si fakt.

6 PY. Që të jemi të qartë, kur po bënit këtë bisedë me Fatmir
7 Limaj edhe ai sikurse thatë ju po ju rezistonte, ju kishit
8 folur ndonjëherë më parë me të apo kjo ishte biseda e parë me
9 këtë person?

10 PË. Nuk kisha folur kurrë më parë me të.

11 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Nuk kam pyetje shtesë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

13 Ka Gjykatësi Mettraux disa pyetje.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësit
15 Smith.

16 Pyetje nga Trupi Gjykses:

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mirëdita. Kam disa pyetje
18 për takimin me personin që ka nofken Çeliku që ju menduat se
19 ishte Fatmir Limaj si dhe Ymer Xhafiqi.

20 Pyetja e parë është kjo: Aso kohe, ju kishit ndonjë
21 informacion që z. Xhafiqi kishte qenë i përfshirë në
22 veprimtari armiqësore në luftime?

23 PË. Jo nuk kisha marrë asnjë informacioni të tillë.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Besoj se në deklaratën
25 tuaj P407, ju keni thënë se ju e kishit kuptuar këtë person si

1 një nëpunës civil i cili nuk kishte fare lidhje me luftimet. I
2 qëndroni kësaj apo keni gjetur informacione të reja ndërkohë
3 që kanë ndryshuar mendimin tuaj?

4 PË. I qëndroj kësaj. E vetmja gjë që mund të shtoj është që
5 unë supozova se MUP-i, hyrja e MUP-it në Randubravë mund të
6 jetë lidhur nga UÇK-ja me z. Xhafiqi sepse ai jetonte në zonë.
7 Ata mund të kenë thënë "Ah, ky është ankuar, ky ka parë flamur
8 shqiptar në zonë" dhe për shkak të faktit se ai raportonte në
9 zonën ku jetonte, kjo në mënyrë të tërthortë solli atë që bëri
10 MUP-i. Po kjo është thjesht hamendësim i im, asgjë më shumë.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Fillimisht nga e morët
12 vesh, nga mësuar ndalimin e z. Xhafiqi, ju kujtohet kush ka
13 qenë personi i parë që ua ka raportuat këtë gjë?

14 PË. Informacionin e parë e kam marrë nga radio, nga shtabi i
15 CC1. Isha ulur në një takim atje në Krushën e Madhe.

16 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju kujtohet kush ka qenë
17 burimi i këtij formacioni?

18 PË. Burimi ose oficeri që mbulonte operacionet, po nuk më
19 kujtohet. Nuk më kujtohet. Nuk më kujtohet. Po ka qenë një
20 mesazh që ka ardhur nga zyrat qendrore të CC1.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Sugjerimi apo propozimi që
22 keni diskutuar disa herë tani që z. Xhafiqi ishte arrestuar,
23 rrëmbyer nga komanda e UÇK-së e Shtabit të Përgjithshëm, ju
24 kujtohet nga ju ka ardhur ky informacion?

25 PË. Informacioni i parë që kemi marrë është thjesht që është

1 rrëmbyer. Dhe u hamendësua që, në qoftë se ishte rrëmbyer
2 atëherë duhet ta kishte rrëmbyer dikush nga ana shqiptare, por
3 nuk pati informacione në ato momente se për llogari të kujt
4 kishte ndodhur veç se kaq u thashë është marrë nga ana
5 shqiptare.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të na thoni pastaj
7 nga u gjet informacioni i mëpasshëm, që ne e pamë para një
8 çasti pra, që ishte komanda e UÇK-së e Shtabit të Përgjithshëm
9 që pretendohet se e kishte kidnapuar, nga erdhi?
10 PË. Kjo frazë është e një raportit që unë e kam parë vetëm
11 gjatë një dëshmie. Nuk jam i sigurt për fjalën "komandë", por
12 Shtabi i Përgjithshëm me siguri u përmend më vonë gjatë asaj
13 dite. Në moment në fillim nuk mua -- unë pata përshtypjen se
14 dikush që ishte lidhur me UÇK-në ishte i përfshirë, po thjesht
15 përfshirje e UÇK-së jo përfshirje e Shtabit të Përgjithshëm në
16 atë fazë.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani ju takoheni me këtë
18 personin Çeliku që ju besonit se ishte z. Limaj, si e gjetët
19 informacionin për të, ku e gjetët kontaktin për të, si menduat
20 ju që ky ishte një person i rëndësishëm për interesimin tuaj?

21 PË. Kur shkuam në mënyrë të organizuar në Tërpezë ku u bë
22 takimi, ai ishte vetë që erdhi tek ne kur dolëm nga
23 automjetet. Ai qartazi po priste për ne atje dhe ishte një
24 person që a ishte caktuar nga të tjerë a kishte caktuar veten
25 që të fliste me ne.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Me sa kuptove ju e kini
2 pyetur, i keni kërkuar që z. Xhafiqi të lirohej ose të paktën
3 ta shihnit edhe ai refuzoi kështu?

4 PË. Kështu.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] E bëri të qartë ai në ato
6 momente, në ato kohë, që z. Xhafiqi është ndaluar nga UÇK-ja,
7 a u larguat ju me përshtypjen se në të vërtetë ai ishte nën
8 kontrollin e UÇK-së apo nën ruajtjen e UÇK-së në ato momente?

9 PË. Është e qartë që e pranoi personi me të cilin bisedova,
10 nuk e kundërshtoi që ishte në duart e UÇK-së. Kjo ishte e
11 gjithë biseda. Nuk u vu në pikëpyetje në ato momente.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Me sa kuptova unë ky
13 personi tha që ky i ndaluari, z. Xhafiqi, ishte shëndoshë e
14 mirë dhe do të trajtohej në përputhje me Konventën e Gjenevës.
15 A ju tha ai nga e dinte këtë gjë, ju tregoi nga e dinte këtë
16 gjë?

17 PË. Tani nuk jam i sigurt a u përdor fjala "shëndoshë e mirë"
18 në këtë kontekst apo në këtë bisedë. E di që doli më vonë
19 gjatë ditës kjo fjalë. Po mua mu dha përshtypja që më së paku
20 ky person do të merrej në pyetje, mbase jo në një mënyrë shumë
21 të mirë, shumë të kujdesshme, po supozova dhe më thanë se nuk
22 do të vritej. Ne menduam që do të ishte i sigurt, por
23 kundërshtimi, arsyeja pse na kundërshtuan pse mos ta shihnim
24 ne ishte që do t'i jepnin shpresë. Pra, objektivi ishte që ai
25 të ishte i frikësuar dhe i tronditur nga rrëmbimi në mënyrë që

1 ai të bashkëpunonte kur ti bënin pyetjet.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra ju po thoni, supozoj
3 unë, që mesa kuptuat ju personi ishte i ndaluar?

4 PË. Ishte e qartë për neve që z. Xhafiqi ishte i ndaluar dhe
5 ishte nën kontrollin e personit me të cilën folëm.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Më herët ju thatë që
7 kishit shqetësime të lidhura me sigurinë e z. Xhafiqi. Thjesht
8 dua që ta sqarojmë pak më tepër këtë gjë. A mund të na thoni
9 sepse i kishit këto shqetësime aso kohe?

10 PË. Jam i sigurt që jo vetëm unë por edhe kolegët e mi ishin
11 shumë të shqetësuar lidhur me atë çfarë mund t'i ngjante,
12 çfarë mund t'i ndodhte, z. Xhafiqi. Kjo, ky shqetësim u rrit -
13 pjesërisht nga qëndrimi apo sjellja e personit që ne kuptuam
14 që ishte Çeliku. Për shembull, mund të ishim siguruar lidhur
15 me atë se çfarë do të ndodhte, në qoftë se do të na thoshte
16 për shembull, "Po do e lëmë të lirë nesër". Dhe në fakt kam
17 pasur një rast të ngjashëm më vonë dhe, për shembull, në qoftë
18 se do të merrnim një përgjigje të tillë siç morën në një rast
19 tjetër kur na tha që dy personat e ndaluar do të liroheshin pa
20 asnjë problem të nesërmen, por në këtë rast nuk na u tha një
21 gjë e tillë.

22 Ky shqetësim i imi u rrit nga sjellja, nga qëndrimi dhe
23 gjithashtu edhe nga mundësia e mohuar për ne për t'u takuar me
24 të burgosurin, në mënyrë të tillë që të mund t'i kishim dhënë
25 kurajo ose shpresë atij. Ne ishim realisht të shqetësuar sa i

1 takon të ardhshmes së menjëhershme të personit të ndaluar.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] I jeni përgjigjur kësaj
3 pyetje, megjithatë më lejoni t'ju pyes edhe një herë. Me sa
4 dini ju, ky personi, z. Xhafiqi a është lejuar ndonjëherë nga
5 UÇK-ja?

6 PË. Me sa di unë jo.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit, Dëshmitar.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
9 Gaynor.

10 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
11 Smith.

12 Dëshmitar, dëshiroj të sqaroj diçka që ka të bëjë me
13 takimin me datë 9 mars 1999 me këtë personin që ju besoni të
14 ketë qenë Fatmir Limaj.

15 Dje, për të gjitha palët, duhet të them që kjo pasqyrohet
16 në faqen 131 dhe 132 të transkriptit. Dje Prokurorja ju pyeti
17 se:

18 "Si e kuptuat ju, me çfarë kompetence foli Fatmir Limaj
19 me ju në takimin me të në datën 9, lidhur me rrëmbimin e
20 Xhafiqit?"

21 Përgjigja që ju dhatë ishte:

22 "Mënyra sesi u soll Limaj me mua më dukej se ai fliste në
23 emër të Shtabit të Përgjithshëm. Nuk është se kisha ndonjë
24 sugjerim tjetër sa i takon nivelit të përfaqësimit të tij. Ai
25 po fliste me mua dhe mënyra sesi e kuptova unë ishte që ai

1 fliste në emër të Shtabit të Përgjithshëm në duart e të cilëve
2 ishte personi i ndaluar.”

3 A ju kujtohet që ta keni thënë këtë përgjigje, Dëshmitar?
4 PË. Po, i nderuar Gjykatës.

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Kemi marrë një shënim
6 përgatitor të Prokurorisë në takimin ju. Për procesverbal
7 është faqja 17 e prova materiale P408. Sipas këtij shënimi
8 thuhet që ju e kuptuar që ai ishte Fatmir Limaj që fliste në
9 emër të Shtabit të Përgjithshëm.

10 A ju kujtohet ta keni diskutuar këtë gjë me Prokuroren?
11 PË. Po.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ju lutem, na e sqaroni,
13 personi që ju e kuptuar që ishte Fatmir Limaj çfarë ju tha ai
14 konkretisht, apo çfarë faktesh ju dha ai që ju bënë juve të
15 besonit që Limaj po fliste në emër të Shtabit të Përgjithshëm.

16 PË. I nderuar Gjykatës, vetë z. Limaj, në qoftë se e kam
17 kuptuar siç duhej interpretimin, përkthimin, z. Limaj vetë e
18 pranoi ose e tha që fliste në emër të Shtabit të Përgjithshëm;
19 atëherë, së pari tha që personi në fjalë ishte nën kontrollin
20 e Shtabit të Përgjithshëm; dhe së dyti z. Limaj kishte njohuri
21 të drejtpërdrejtë. Kështu që në qoftë se i mbledh këto të dyja
22 bashkë, unë e kuptova që ai fliste në emër të Shtabit të
23 Përgjithshëm. Ose që e prezantoi veten se fliste në emër të
24 Shtabit të Përgjithshëm.

25 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A tha ndonjë gjë ai vetë, që

1 kohët e fundit për shembull kishte qenë në kontakt me Shtabin
2 e Përgjithshëm.

3 PË. Jo, nuk tha asgjë konkrete të kësaj natyre, i nderuar
4 Gjykatës.

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Këto pyetje kisha. Shumë
6 Faleminderit.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
8 Barthe.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
10 Smith.

11 Mirëdita, z. Young.

12 PË. Mirëdita.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kam dy ose tre pyetje për
14 ju.

15 Më herët sot besoj që gjatë kundërpvetjeve nga z.
16 Roberts, nga Mbrojtja e z. Selimi, ju thatë përgjigjen e
17 mëposhtme në përgjigje të pyetjes që kishte të bënte me
18 takimin e personit për të cilin folët edhe më herët, z. Limaj
19 ose Çeliku.

20 Për procesverbal po lexoj transkriptin, faqja 20, rreshti
21 20, faqja 31, rreshti 3.

22 "PY. Ju nuk keni pasur asnjëherë asnjë dyshim lidhur me
23 atë kë keni takuar? A është ky një vlerësim i asaj çfarë ju
24 donit të thoni?"

25 Dhe ju përgjigjeni, sipas transkriptit, se:

1 "Mendoj se është paksa ndryshe që kjo mu bë mua e njohur
2 duke marrë parasysh llojin e operacioneve dhe zotërinë e
3 përfshirë përpara meje."

4 Pyetja që kam për juve është kjo, z. Young: Kur thoni që
5 e njihja llojin e operimit të zotërisë që e kishit përpara,
6 çfarë donit të thonit? A mund t'ja shpjegoni Trupit Gjykses se
7 çfarë nënkuptoni me këtë shprehje?

8 PË. Të nderuar Gjykatës, unë nuk kam njohuri të hollësishme
9 për historikun e z. Limaj. Megjithatë, e kuptova që ai ishte
10 dikush dhe nuk është se dua ta them në kontekstin negativ këtë
11 gjë. Por, unë e kuptova që personi ishte i rrezikshëm. Nuk po
12 e them si kritikë, por po e them si çështje fakti. Mënyra sesi
13 e kuptova unë ishte që ai ishte një zotëri që funksiononte në
14 një mënyrë të caktuar sekrete dhe jo si dikush që kishte për
15 shembull kontaktet e rregullta bashkëpunuese me KVM-në. Unë
16 nuk kam fare asnjë lloj informacioni të hollësishëm sa i takon
17 historikut të tij të mëhershëm.

18 Emri i tij ishte përmendur, kishte dalë disa herë. E kam
19 përmendur edhe në deklaratën time se zotëria shqiptar që më
20 lexoi një fragment, një paragraf nga një gazetë shqiptare nuk
21 e di se çfarë motivesh kishte ai dhe nuk është se unë e kam
22 përkthyer vetë atë artikull gazete, por aso kohe e mbaj mend
23 që kam menduar që ky është një person me të cilin duhet të
24 jesh i kujdesshëm. Është një person që mbase është i përfshirë
25 në zhdukje të mëhershme. Pra, kjo ishte diçka që më erdhi në

1 mendje përnjëherë, që ky mund të ishte i përfshirë në zhdukjen
2 e personave nga të dyja kombësitë e përfshira në konfliktin e
3 1998. Unë krijova përshtypjen, pata përshtypjen që z. Limaj
4 ishte disi i përfshirë në to.

5 Emri i tij kishte dalë edhe në sesionet informuese.
6 Megjithatë, në atë kohë unë nuk dija një historik të
7 hollësishëm të veprimtarive në të cilat ishte i përfshirë ai.
8 Asnjëherë nuk ishte se kisha lexuar ndonjë gjë që përfshinte
9 atë, ose ndonjë raport të hollësishëm që përfshinte
10 informacion për të. Pavarësisht kësaj, unë kisha njohuri ose
11 besim të mjaftueshëm, informacion në mendjen time, pavarësisht
12 burimeve që mua më bënte të besoja që ky është një person nga
13 i cili duhet të kesh kujdes, sepse në të kundërtën, po të mos
14 ishte kështu, do të isha përpjekur ta vazhdoja më tej takimin
15 me të në Tërpezë, dhe do të kisha vendosur që të isha më
16 insistues, siç kisha bërë me persona të tjerë gjatë ushtrimit
17 të detyrës time në Kosovë.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në rregull, është e qartë.

19 Sa i takon fotografisë së këtij personi, bëhet fjalë për
20 një fotografi apo për më shumë sesa një fotografi?

21 PË. Vetëm për një fotografi.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të kujtoni se ku dhe
23 kur e keni parë fotografinë më përpara sesa të ndodhte takimi?

24 Nuk e di, javë përpara, muaj përpara?

25 PË. Javë përpara.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pyetja e fundit. A mund të
2 na thoni më shumë hollësi lidhur me këtë fotografi? Për
3 shembull si dukej personi te kjo fotoja, te fotografia? Ishte
4 i veshur me uniformë, ishte vetëm, ishte i shoqëruar me dikë
5 tjetër?

6 PË. Ishte bashkë me të tjerë, me persona të tjerë, të nderuar
7 Gjykatës. E kam theksuar më herët dhe dua ta theksoj edhe një
8 herë, siç mund ta kuptoni, të nderuar Gjykatës, nuk po bëj --
9 thjesht qëllimi është që më përkonte fotografia me personin.
10 Nuk është se dua të futem në hollësi të tjera identifikuese,
11 por thjesht mund ta lidhja personin në fotografi me personin
12 përpara.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A ju kujtohet a kishte
14 veshur uniformë ai në atë fotografi apo jo?

15 PË. Nuk e di, nuk jam i sigurt. E kam menduar edhe këtë
16 pyetje, por nuk jam i sigurt, nuk di të them. Besoj se po.
17 Por, nuk mund ta them me siguri këtë gjë, nuk them dot jo.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Këto ishin pyetjet e mia.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka pyetje
20 pasuese?

21 Prokurorja?

22 ZNJ. MAYER: [Përkthim] Jo.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Misetic,
24 ju?

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, z. Kryetar, do të

1 jem i shkurtër në pyetjet e mia.

2 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Misetiç:

3 Z. MISETIÇ: [Përkthim]

4 PY. Dëshmitar, do ju bëj disa pyetje të lidhura me pyetjet që
5 ju bëri Gjykatësi Barthe. Ju thoni në formulimin tuaj që
6 fotografia e z. Limaj që keni parë ishte në përputhje me
7 personin që pe, ose përkonte me personin që pe. A na e
8 përshkruan pak të lutem se ç'a do të thuash me këtë që përkonte
9 me personin që pe? Çfarë do të thuash me këtë?

10 PË. Moshë, dhe fakti që nuk kishte ndonjë gjë shumë të
11 ndryshëm ndërmjet fotografisë dhe personit. E kam thekuar se
12 ka kufizime kjo mënyrë, si e kisha kuptuar unë ose si e kisha
13 bërë lidhjen e fotografisë me personin, por e dija që e kisha
14 parë në fotografi dhe pasi u takova me këtë zotëri, dhe pasi
15 më treguan, pasi më thanë që ishte z. Limaj, nuk kisha
16 vështirësi fare që të pranoja ngjashmëri ndërmjet fotografisë
17 dhe personit. Po të kishte qenë ndryshe do e kisha thënë.

18 PY. A ju kanë thënë ndonjëherë kolegët tuaj ose persona të
19 ndryshëm që ka pasur shumë persona brenda UÇK-së ose në atë
20 rajon në përgjithësi që përdornin emrin Çeliku?

21 PË. Jo, nuk më është thënë asnjëherë një gjë e kësaj natyre.

22 PY. A ju është treguar ndonjëherë ndonjë fotografi e njerëzve
23 të tjerë që e kanë përdorur emrin e përgjithshëm Çelik në atë
24 rajon, nuk ka qenë vetëm një person me emrin Çelik?

25 PË. Jo. Mbase kur më është përdorur emri Çelik më përpara,

1 Çelik gjithmonë lidhet me Fatmir Limajn. Nuk kam asnjë
2 informacion që mua të më bënte të mendoja që kishte më shumë
3 sesa një Çelik. Por gjithmonë kur thuhej nofka Çeliku, dhe
4 emri, mbiemri i personit, për mua ishin gjithmonë të lidhura
5 pazgjidhshmërisht me njëri-tjetrin.
6 PY. Në rregull. Tani më lejoni t'ju bëj një pyetje që ju bëri
7 Gjykatësi Mettraux, që përmendi njësitin komando të Shtabit të
8 Përgjithshëm.

9 Në qoftë se unë do ju thoja që OSBE-ja më 9 mars raportoi
10 se ka pasur një njësit policie të kontrolluar nga Shtabi i
11 Përgjithshëm të përfshirë dhe që i është raportuar OSBE-së nga
12 komandant Drini a do të ishte bërë kjo gjatë takimit, gjatë
13 kohës që keni bërë takimin juve apo mendoni që komandant Drini
14 ka bërë ndonjë tjetër takim me OSBE-në atë ditë? Bëhet fjala
15 për një takim apo dy takime të ndryshëm?

16 PË. Nuk kam informacion të drejtpërdrejtë sa i takon
17 takimeve. Jam i sigurt që ka pasur më shumë sesa një kontakt
18 ndërmjet OSBE-së dhe komandant Drinit atë ditë, po thjeshtë
19 unë nuk kam qenë po thjesht unë nuk kam qenë i përfshirë në
20 takimet e tjera.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Do t'ju kërkoja që të kalonim për
22 një minutë në seancë private.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.
24 Sekretare na kaloni në seancë private.

25 [Seancë private]

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4 [Seancë e hapur]

5 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
6 jemi në seancë publike.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

8 Znj. Sekretare, do ju lutesha të paraqesim në ekran
9 dokumentin KSC-BC-2020-06-U007-9618-U007-9620-ET RED2. Faqen e
10 tretë të këtij dokumenti.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Është prova materiale
12 P406.

13 Z. MISETIC: [Përkthim]

14 PY. Dëshmitar, tani më thonë që pjesa e këtij dokumenti që
15 dëshiroja të ta përdorja si bazë për pyetjen time nuk është
16 bashkëlidhur në këtë raport. Më thuhet që është në versionin
17 në shqip por nuk është në anglisht. Kjo nuk do të na ndihmonte
18 shumë. Pra, bëhet fjalë për një deklaratë të bashkëshortes të
19 z. Xhafiqi.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Për procesverbal, më falni një
21 moment derisa ta konfirmoj, është në faqen U007-9620 për
22 procesverbal.

23 PY. Dhe do t'jua lexoj. Është një raport që e ka hartuar ajo,
24 e ka bërë ajo, bashkëshortja, pra dhe në këtë faqe thuhet.

25 Pyetja që i bëhet është që:

1 "A mund t'i përshkruani dot këto tri persona?"

2 Ajo thotë:

3 "Unë vura re që këta tri persona kishin rroba me ngjyrë
4 të gjelbër, por nuk kam parë asgjë tjetër."

5 Pyetja që kam për juve është që a të kujtohet kush e ka
6 thënë që këto personat do të kishin veshur uniforma të zeza
7 dhe jo me kamuflazh, ose të gjelbërta? A ju kujtohet kush jua
8 ka thënë këtë gjë?

9 PË. Jo.

10 PY. Faleminderit.

11 Z. MISETIC: [Përshkrim] Nuk kam pyetje të tjera të nderuar
12 Gjykatës.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përshkrim] Z. Emerson?

14 Z. EMMERSON: [Përshkrim] Nuk kam.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përshkrim] Z. Roberts?

16 Z. ROBERTS: [Përshkrim] Kam vetëm një pyetje, nëse më
17 lejoni.

18 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Roberts:

19 Z. ROBERTS: [Përshkrim]

20 PY. Dëshmitar, ju e sqaruat që personi që ju tha ju që fliste
21 në emër të Shtabit të Përgjithshëm ishte Çeliku. E keni
22 identifikuar si Çeliku këtë person. Besoj që këtë përgjigje i
23 dhatë edhe Prokurores edhe pyetjes së Gjykatësit Gaynor.
24 Megjithatë, siç e kam kuptuar unë shënimin përgatitor nuk më
25 dilte e qartë se ishte ky rast.

1 Megjithatë, pavarësisht se ishte përgjigja apo jo, ju nuk
2 është se keni ndonjë provë që ju vërtetoi juve që personi
3 fliste në emër të Shtabit të Përgjithshëm.

4 PË. Jo, thjesht m'u krijua përshtypja. Domethënë ishte
5 përfundimi im personal, por nuk është se kisha prova.

6 PY. Domethënë, është thjeshtë përfundimi juaj megjithatë, nuk
7 është e thënë se ka ndonjë provë lidhur me këtë apo jo?

8 PË. Po.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
10 Z. Ellis, pyetje?

11 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
13 kemi përfunduar këtu me dëshminë tuaj. Faleminderit që ishit
14 me ne sot, Faleminderit që ndatë informacionin që dinit. Tani
15 mund të largoheni nga salla e gjyqit. Ju urojmë gjithë të
16 mira.

17 Sekretarja do t'ju nxjerrë nga salla.

18 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Kam një çështje organizative për
20 të ngritur.

21 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shumë mirë,
23 mund të vazhdoni.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] A mund të kalojmë në seancë
25 private për një moment.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Le të kalojmë
2 në seancë private.

3 [Seancë private]

4 [Seancë private teksti i fshirë]

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8 [Seancë e hapur]

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
10 jemi në seancë publike.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kujtoj që
12 do të rivazhdojmë me datën 25. Do të punojmë tre ditë atë
13 javë.

14 Ju falënderoj të gjithëve për kontributin tuaj. E mbyllim
15 seancën këtu deri me datën 25.

16 --- Seanca mbyllet në orën 15.51

17

18

19

20

21

22

23

24

25